Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit

Kosovë

Raport vjetor 2021

1 janar - 31 dhjetor 2021

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut – Sekretariati
Rr. Rrustem Statovci nr. 29 – 10000 Prishtinë – Kosovë
Tel: +383 (0) 38 28 2207
Email: office@hrrp.eu
www.hrrp.eu

Parathënie

Ky është raporti vjetor i dymbëdhjetë i Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut (këtu e tutje, "Paneli" ose "PShDNj") që mbulon periudhën nga 1 janari 2021 deri më 31 dhjetor 2021.

Ky raport është përgatitur nga Paneli dhe i prezantohet Misionit, shteteve anëtare të BE-së dhe shteteve të treta kontribuese, si dhe publikut të gjerë me qëllim të shpërndarjes së informacionit mbi zhvillimin e praktikës gjyqësore dhe aktiviteteve të Panelit.

Gjatë periudhës raportuese, Paneli zhvilloi pesë (5) seanca dhe miratoi gjithej njëzet e një (21) vendime në katërmbëdhjetë (14) raste.

Siç ka qenë situata në përgjithësi, viti 2021 është shënuar për Panelin me pasoja nga Covid-19. Kufizimet ndërkombëtare të udhëtimit dhe masat për distancë sociale brenda Kosovës e kanë detyruar Panelin dhe, në veçanti, Sekretariatin e tij, të riorganizojë punën dhe metodat e tij. Të gjitha prej pesë (5) sencave të Panelit të mbajtura në vitin 2021 janë zhvilluar përmes video-lidhjes. Po ashtu, janë mbajtur dy (2) takime ndërmjet Panelit dhe shefit të Misionit të EULEX-it, të cilat gjithashtu është dashur të mbaheshin përmes video lidhjes (22 prill 2021 dhe 23 shtator 2021).

Seancat e mbajtura nga distanca të Panelit u përgatitën me kujdes për të siguruar që diskutimet në internet të ishin sa më efektive. Përkundër sfidave, Paneli ka marrë njëzet e një (21) vendime gjatë kësaj periudhe. Kjo përfshin tri (3) vendime ekskluzivisht për meritat; gjashtë (6) vendime së bashku mbi pranueshmërinë dhe meritat; dhe gjashtë (6) vendime pasuese.

Megjithëse disa nga veprimtaritë e fushatës informuese të Panelit ishte dashtur të shtyheshin për shkak të rrethanave që mbizotëronin, Paneli në ditën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut lancoi dy (2) video, ku ka përshkruar se si mund të parashtrohet ankesa dhe se si Paneli i proceson ankesat.

Përveç kësaj, Paneli publikoi një raport të ndërmjetëm vlerësimi që mbulon dhjetë (10) vitet e para të punës (2010-2020). Ky raport vlerëson efektivitetin e Panelit si mekanizëm i llogaridhënies ndaj të drejtave të njeriut për një mision ndërkombëtar. Në diskutimin e parë të këtij raporti të vlerësimit të ndërmjetëm, Misioni hodhi poshtë shumicën e konsideratave të Panelit. Paneli mbetet i angazhuar në këtë çështje.

Sekretariati është prekur veçanërisht nga rrethanat dhe duhet të vlerësohet për përpjekjet, qëndrueshmërinë dhe shkathtësinë e treguar gjatë asaj periudhe të vështirë kohore.

Paneli ka pësuar ndryshime të mëdha në përbërje gjatë vitit 2021. Si rezultat i këtyre ndryshimeve, Paneli në fakt nuk ishte në gjendje të funksiononte gjatë tremujorit të katërt të vitit 2021, për shkak të mungesës së anëtarëve të jashtëm të panelit.

Ndryshimet kanë ardhur si pasojë e dorëheqjeve të anëtarëve të panelit. Së pari, në mars, anëtarja e EULEX-it, Anna Bednarek, u largua nga misioni dhe liroi pozitën e saj në Panel. Në prill, anëtari kryesues, Guénaël Mettraux, dha dorëheqjen nga Paneli, duke hequr dorë nga detyrat e anëtarit kryesues për Anna Autio-n. Më pas, në shtator 2021, znj. Autio gjithashtu dha dorëheqjen nga Paneli.

Pas një procedure të brendshme rekrutimi, në korrik 2021, z. Alexander Fassihi u emërua anëtar i Panelit nga EULEX-i për të zëvendësuar Anna Bednarek. Procedura e parë e përzgjedhjes në maj-qershor për një anëtar të ri të jashtëm nuk arriti të identifikojë ndonjë kandidat të përshtatshëm. Pas një procedure të dytë të përzgjedhjes në gusht-shtator, znj. Snježana Bokulić u zgjodh dhe u emërua anëtare e jashtme e Panelit në dhjetor 2021. Një procedurë e re rekrutimi filloi pak para fundit të vitit për të identifikuar një anëtar të dytë të jashtëm.

Paneli dëshiron të shfrytëzojë këtë rast për të falenderuar anëtarët që janë larguar, Anna Bednarek, Guénaël Mettraux dhe Anna Autio për kontributet e tyre shumë të vlefshme në punën e Panelit.

Në vitin 2021 u regjistrua një (1) ankesë e re. Paneli përfundoi një (1) rast, duke arritur në përfundimin se përcjellja e mëtutjeshme e rastit nuk do të ishte efekive.

Që nga 31 dhjetori 2020, numri i lëndëve në pritje ishte njëzet e katër (24) raste. Nga këto, njëzet (20) raste kur ishte konstatuar shkelje e të drejtave të ankuesit mbeten të hapura dhe i nënshtrohen vlerësimit të zbatimit të rekomandimeve të Panelit nga shefi i Misionit.

Nga njëzet e katër (24) raste në pritje, njëzet (20) kanë të bëjnë me rastet e zhdukjeve me forcë gjatë dhe pas konfliktit të Kosovës 1998-1999. Të gjitha këto raste fillimisht iu komunikuan shefit të Misionit të EULEX-it në dhjetor 2017. Asnjë përparim nuk u bë në këto raste gjatë vitit 2018 në një pjesë të madhe për shkak të rikonfigurimit të Misionit. Gjatë vitit 2019 dhe 2020, përgjigjet nga shefi i Misionit janë parashtruar në nëntëmbëdhjetë (19) nga këto raste. Në fund të vitit 2021, vetëm një (1) rast i zhdukjeve të detyruara mbeti ende në pritje të një përgjigje të parë nga shefi i Misionit. Sipas Misionit, ka informacion në lidhje me këtë rast të mbetur që kërkon miratim paraprak nga autoritetet vendore para se të lëshohet në Panel.

Rastet e personave të zhdukur (ose zhdukjes me forcë) datojnë që nga konflikti 1998-1999 ose pasojat e tij menjëherë, kohë kur Misioni nuk ekzistonte ende. Fillimisht, këto raste ishin nën përgjegjësinë e UNMIK-ut para se ato të binin nën përgjegjësinë e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit, EULEX-i Kosovë (këtu e tutje, "Misioni") kur Misioni u krijua në vitin 2008. Këto raste janë simbol i punës së Misionit, por edhe i dështimeve të tij. Gjithnjë e më shumë vërehet nga ankesat që kanë ardhur në Panel se Misioni ka dështuar në përpjekjet e tij për të sjellë drejtësi dhe përgjegjësi për të afërmit e mbijetuar të të zhdukurve. Për një dhjetëvjeçar, përgjegjësia për të hetuar ato raste ishte e Misionit. Megjithëse u përball me sfida dhe vështirësi të mëdha, Misioni gjithashtu nuk arriti të përmbushë detyrimet e veta ndaj të drejtave të njeriut në lidhje me ato raste. Disa nga mangësitë e vërejtura nga Paneli ishin sistematike. Ato tregojnë mungesë planifikimi dhe bashkërendimi të brendshëm, mungesë vizioni, mungesë të një politike të nevojshme në lidhje me rastet që përfshijnë pretendime për shkelje të rënda të të drejtave të njeriut, mungesë prioritizimi adekuat dhe mungesë të përgjithshme përqëndrimi. Ata gjithashtu tregojnë mungesë të të kuptuarit të detyrimeve të Misionit ndaj të drejtave të njeriut, veçanërisht në operacionet e tij.

Misioni gjithashtu nuk arriti të adresojë plotësisht të metat dhe mangësitë që kishin mbetur nga Misioni i UNMIK-ut, i cili i kishte paraprirë. Kjo bëri që disa nga dështimet e UNMIK-ut *të barteshin* në Mision dhe të vazhdonin. Si rezultat, vetëm një pjesë e vogël e rasteve të personave të zhdukur që ishin në kompetencën e Misionit dhe të cilat ishte obligim si çështje e ligjit ndaj të drejtavetë njeriut që të hetoheshin, në fakt u hetuan. Shumica dërrmuese e tyre mbetën të paprekura.

Gjithashtu shqetësuese në atë drejtim është dështimi i Misionit për të vendosur një politikë komunikimi që do t'i kishte mundësuar të komunikonte me të afërmit dhe anëtarët e mbijetuar të familjeve të të zhdukurve. Familjet u lanë të përpiqeshin të gjenin vetë informacion, ku Misioini shumë rrallë ishte i angazhuar ose efektiv për t'i ndihmuar ata.

Si rezultat, dy dekada dhe dy misione ndërkombëtare më vonë, situata e personave të zhdukur në Kosovë është akoma pothuajse në të njëjtën pikë siç ishte menjëherë pas konfliktit për sa i përket të drejtave të njeriut dhe përgjegjësisë. Kjo pavarësisht përpjekjeve më të mira dhe numrit në rritje të vendimeve nga Paneli për këtë temë.

Rekomandimet e Panelit në lidhje me rastet që kanë të bëjnë me personat e zhdukur janë zbatuar vetëm pjesërisht nga Misioni. Dy shqyrtime janë veçanërisht problematike në atë drejtim. E para është refuzimi i vazhdueshëm i Misionit për të pranuar faktin se ka shkelur të drejtat themelore të ankuesve përkundër

që Paneli e ka gjetur këtë dhe përkundër faktit se ky realitet është i pashmangshëm. Ky refuzim duket se motivohet nga shqetësimi i Misionit se mund të mbahej ligjërisht i përgjegjshëm nëse do ta pranonte atë fakt. Sipas mendimit të Panelit, ky shqetësim është teorik sesa real. Për më tepër, edhe nëse është e vërtetë, do të ishte një ironi e madhe që Misioni do të merrte hapa për ta bërë veten të papërgjegjshëm kur vetë mandati i tij është të sigurojë përgjegjësi për të tjerët.

Në diskutimet me Panelin gjatë vitit 2021, Misioni ka premtuar se do të organizojë takime individuale me të gjitha familjet e rasteve të personave të zhdukur. Deri në fund të vitit 2021, nuk është organizuar apo zhvilluar ende ndonjë takim. Paneli është i kënaqur që shefi i Misionit pajtohet që të afërmit kanë të drejtë të dinë se çfarë ka ndodhur, se kjo është e drejta e tyre themelore e njeriut dhe se autoritetet kudo kanë obligim ndërkombëtar dhe ligjor të bëjnë gjithçka që munden. Paneli njeh punën e EULEX-it për të mbështetur autoritetet e Kosovës në adresimin e këtyre obligimeve dhe rithekson se EULEX-i duhet të zbatojë plotësisht rekomandimet e Panelit.

Snježana Bokulić
Kryesuese e Panelit
Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

Tabela e përmbajtjes

Parathënie 2

1. Korniza rregullative 6

1.1. Veprimi i Këshillit CFSP 2018/856 i datës 8 qershor 2018 6

1.2. Veprimi i përbashkët i Këshillit 2008/124/CFSP i datës 4 shkurt 2008 për Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit EULEX-i Kosovë 6

1.3. Koncepti i llogaridhënies i EULEX-it Kosovë – Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, Sekretariati i përgjithshëm i Këshillit, Bruksel, i datës 29 tetor 2009 6

1.4. Instrumentet e zbatueshme ndërkombëtare për të drejtat e njeriut 7

1.5. Rregullorja e punës 7

2. Numri i lëndëve dhe subjekti i ankesave 8

2.1. Nummri i lëndëve dhe statistikat 8

2.2. Subjekti i ankesave 9

2.3. Seancat e Panelit 9

3. Jurisprudenca 9

3.1. Hyrje 9

3.2. Vendimet për meritat 10

3.3. Vendimet e pranueshmërisë 13

3.4. Vendimet rreth kërkesave për rishqyrtim 13

3.5. Vendimet pasuese 13

4. Aktivitetet e tjera të Panelit 15

4.1. Takimet 15

4.2. Fushata informuese e vitit 2021 15

4.2.1. Takimet me organizatat kosovare 16

4.3. Trajnimi hyrës 16

4.4. Faqja e internetit e PShDNj-së 16

4.5 Llogaridhënia e të drejtave të njeriut në kontekstin e misionit të EULEX-it në Kosovë për Sundimin e Ligjit – Vlerësimi i Përkohshëm 17

5. Paneli dhe Sekretariati 17

5.1. Anëtarët e Panelit 17

5.1.1. Ndërhyrja e Misionit në pavarësinë e Panelit 18

5.1.2. Kryesuesi i Panelit 18

5.1.3. Anëtarët deri më 31 dhjetor 2021 19

5.2. Sekretariati 20

6. Çështjet operative dhe administrative 20

6.1. Buxheti 20

6.2. Burimet njerëzore 20

7. Konkluzionet dhe rekomandimet 21

7.1 Konsideratat e përgjithshme 21

7.3 Programi i reparacionit 21

7.4 Rastet e personave të zhdukur 22
7.5 Misioni dhe të drejtat e njeriut 23
SHTOJCA 1 Statistikat 2010 – 2021 24
SHTOJCA 2 TABELA E SHKELJEVE ME VENDIMET PASUESE – 31 dhjetor 2021 25
SHTOJCA 3 Vendimet e Panelit 2010-2021 26

1. Korniza rregullative

Baza ligjore për funksionimin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, EULEX-i Kosovë (këtu e tutje, "Misioni"), rrjedh përgjithësisht nga Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244(1999) e datës 10 qershor 1999 dhe sigurohet në mënyrë specifike me vendime të Këshillit Evropian të Bashkimit Evropian. Këto vendime të Këshillit shërbejnë për të zbatuar Politikën e Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes (PPSM) të Bashkimit Evropian.

1.1. Veprimi i Këshillit CFSP 2018/856 i datës 8 qershor 2018

Në mandatin e tij aktual, të ndryshuar me Vendimin e Këshillit CFSP 2018/856, EULEX-i Kosovë monitoron lëndët dhe seancat gjyqësore të përzgjedhura në institucionet penale dhe civile të Kosovës. Kjo përfshin, por nuk kufizohet vetëm në lëndët që i janë dorëzuar institucioneve kompetente të Kosovës. Për më tepër, EULEX-i Kosovë mban një numër të kufizuar të kompetencave ekzekutive, ndër të tjera, në lidhje me mbrojtjen e dëshmitarëve, inteligjencën kriminale dhe ruajtjen e rendit publik, si reagues i dytë nga autoritetet vendore.

1.2. Veprimi i përbashkët i Këshillit 2008/124/CFSP i datës 4 shkurt 2008 për Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit EULEX-i Kosovë

Veprimi i përbashkët i Këshillit është burim i autoritetit dhe kompetencave të Misionit EULEX-i Kosovë. Në atë veprim përcaktohet *mandati* i EULEX-it Kosovë dhe, ndër të tjera, specifikohet përgjegjësia e tij për të vepruar në përputhje me standardet përkatëse për të drejtat e njeriut, neni 3 (i): *"të sigurojë që të gjitha aktivitetet e tij t'i respektojnë standardet ndërkombëtare lidhur me të drejtat e njeriut dhe përfshirjen gjinore"*.

1.3. Koncepti i llogaridhënies i EULEX-it Kosovë – Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, Sekretariati i përgjithshëm i Këshillit, Bruksel, i datës 29 tetor 2009

Themelimi i një mekanizmi të pavarur, efektiv dhe transparent për llogaridhënie në lidhje me të drejtat e njeriut ishte konsideruar të jetë kriter themelor për EULEX-in Kosovë si mision për sundim të ligjit me disa funksione ekzekutive të kufizuara. Këto funksione ekzekutive përfshinin funksione të ndryshme në polici dhe prokurori, të rezervuara për zyrtarët e EULEX-it në lidhje me ruajtjen e rendit publik, hetimin penal dhe ndjekjen penale, veçanërisht për krime të luftës dhe krim të organizuar, dhe ndihmës në antropologjinë e mjekësisë ligjore. Ky mekanizëm i jashtëm i llogaridhënies kishte për qëllim ta plotësonte llogaridhënien e përgjithshme të Misionit EULEX-i Kosovë, siç parashihet me Skemën e Sigurimit të Përgjegjësisë për Palën e Tretë dhe Mekanizmin e Brendshëm Disiplinor të EULEX-it.

Andaj, Koncepti i llogaridhënies përcaktoi *mandatin* e Panelit që: *të shqyrtojë ankesa nga çdo person, që nuk është pjesë e personelit të EULEX-it Kosovë që pretendon të jetë viktimë e shkeljes së të drejtave të njeriut nga EULEX-i Kosovë gjatë zbatimit të mandatit ekzekutiv të EULEX-it Kosovë*.[1]

Megjithatë, sipas Konceptit të llogaridhënies, Paneli nuk ka juridiksion në lidhje në gjykatat e Kosovës. Fakti se gjykatësit e EULEX-it janë anëtarë të trupit gjykues të ndonjë gjykate të caktuar nuk e ndryshon karakterin e këtyre gjykatave si gjykata të Kosovës.

Paneli e ka miratuar rregulloren e punës më 10 qershor 2010, ku pas kësaj date Paneli është autorizuar të pranojë ankesa. Paneli i ka ndryshuar rregullat e veta më 21 nëntor 2011 dhe 15 janar 2013, 15 janar 2019 dhe prapë më 11 dhjetor 2019.

1.4. Instrumentet e zbatueshme ndërkombëtare për të drejtat e njeriut

Në pajtim me dispozitat e Konceptit të llogaridhënies, Paneli mund të shqyrtojë ankesa në lidhje me pretendimet e shkeljeve, në mes të tjerash, të instrumenteve të të drejtave të njeriut si në vijim:

- Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (1948)
- Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (Konventa, 1950)
- Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor (KEDR, 1965)
- Marrëveshja Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (MDCP, 1966)
- Marrëveshja Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (MDESK, 1966)
- Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Femrave (KEFDF, 1979)
- Konventa kundër Torturës dhe Trajtimit apo Dënimit tjetër Mizor, Çnjerëzor apo Poshtërues (KKT, 1984)
- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijëve (KDF, 1989)

Në praktikë, ankesat që janë paraqitur deri më sot kryesisht janë bazuar në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Protokollet e saj. Një numër i ankesave po ashtu i janë referuar Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, marrëveshjeve ndërkombëtare dhe instrumenteve të tjera të të drejtave të njeriut. Janë bërë referenca gjithashtu në një numër rastesh për praktikën gjyqësore të Gjykatës Ndër-Amerikane të të Drejtave të Njeriut, Konventat e Gjenevës dhe Statutit të Romës të Gjykatës Penale Ndërkombëtare.

1.5. Rregullorja e punës

Si pasojë e hyrjes në fuqi më 15 qershor 2018 të Vendimit të Këshillit CFSP 2018/856, mandati dhe përbërja e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut u ndryshua gjithashtu. Për të pasqyruar këto ndryshime, Rregullorja e punës duhej të ndryshohej.

Më 15 Janar 2019, Paneli miratoi Rregulloren e tij të ndryshuar të Procedurës për të arsyetuar ndryshimin e mandatit të Misionit dhe nevojën për të rikompozuar Panelin.

Më 11 dhjetor 2019, Paneli miratoi një amendament në rregullin 43 të Rregullores së punës, për të lejuar që të dy palët në një ankesë të jenë në gjendje të paraqesin kërkesë për rishikimin e gjetjeve të një vendimi të Panelit, në rrethana kur informacioni i ri kishte dalë në dritë, e që nuk ishte në dispozicion në kohën kur Paneli kishte marrë vendimin e tij fillestar.

[1] Koncepti i llogaridhënies është pjesë e planit operacional të EULEX-it. Ai është dokument i kufizuar dhe nuk është i qasshëm për publikun. Paneli nuk është i lirë t'i zbulojë hollësitë që gjenden aty.

Rregullorja e Procedurës është në dispozicion në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe në faqen e internetit të Panelit, në https://hrrp.eu/alb/reference-documents.php.

1.6. Procedimi i rishikuar dhe i shpejtë i lëndëve

Me një letër të datës 18 shtator 2020, Paneli informoi shefin e Misionit të EULEX-it se, në për shkak të pandemisë së koronavirusit dhe masave të marra për të zbutur efektet e saj, janë shkaktuar vonesa si në përpunimin e ankesave në pritjeve në Panel, ashtu edhe në komunikimet ndërmjet Panelit dhe ankuesve. Prandaj, Paneli vendosi dhe informoi Misionin se, me qëllim të përshpejtimit të procedimit të lëndëve në pritje, duke filluar nga fundi i vitit, Paneli përgjithësisht do të merret me lëndë të pranueshmërisë dhe meritës në të njëjtën kohë në një vendim të vetëm.

2. Numri i lëndëve dhe subjekti i ankesave

2.1. Nummri i lëndëve dhe statistikat

Që nga 1 janari 2021, numri i lëndëve në pritje ishte njëzet e katër (24).

Paneli ka pranuar një (1) ankesë të re në vitin 2021.

Paneli ka përfunduar një (1) rast pasi ka përcjellur zbatimin e rekomandimeve të tij.

Paneli ka shpallur gjashtë (6) raste të pranueshme dhe gjeti se Misioni kishte shkelur të drejtat e njeriut të ankuesve në nëntë (9) raste.

Në pesë (5) raste u morën vendime pasuese, ku Paneli ka vazhduar të vlerësojë zbatimin e rekomandimeve të tij.

Numri i lëndëve në pritje më 31 dhjetor 2021 ishte njëzet e katër (24) lëndë.





2.2. Subjekti i ankesave

Ankesat të cilat u shqyrtuan nga Paneli në vitin 2021 kryesisht kishin të bënin me raste të zhdukjeve me forcë, të cilat kishin ndodhur gjatë ose menjëherë pas konfliktit 1998-1999 në Kosovë. Ankesat kanë të bëjnë veçanërisht me shkeljet e pretenduara të së drejtës për jetë nën pjesët e saj procedurale dhe të drejtën për mos iu nënshtruar torturës, trajtimit çnjerëzor ose poshtërues si rezultat i vuajtjeve të shkaktuara nga zhdukja dhe mungesës së një hetimi efektiv, siç garantohet nga nenet 2 dhe 3 të Konventës Evropiane.

Një nga ankesat e shqyrtuara gjatë vitit 2021 kishte të bënte me të drejtën për respektimin e jetës private të një palë të tretë në lidhje me një proces penal. Ankesa kishte të bënte në veçanti me mënyrën në të cilën një prokuror i EULEX-it kishte shprehur mendimet për ankuesin në një intervistë televizive pas përfundimit të një gjykimi penal. Ankuesi nuk ishte palë në këtë gjykim penal dhe pretendoi se përmes këtyre deklaratave publike Misioni kishte shkelur të drejtën për respektimin e jetës private të garantuar me nenin 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore.

2.3. Seancat e Panelit

Gjatë vitit 2021, Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut ka mbajtur pesë seanca. Për shkak të kufizimeve të udhëtimit dhe masave të distancës sociale të vendosura nga 15 marsi 2020, për zbutjen e pandemisë së koronavirusit, të gjitha seancat u zhvilluan përmes mjeteve elektronike, siç autorizohet nga rregulli 13. *Shqyrtimet, Paragrafi 3* i rregullores së punës.

- Seanca e 48-të: 12 shkurt 2021;
- Seanca e 49-të: 26 mars 2021;
- Seanca e 50-të: 29 prill 2021;
- Seanca e 51-të: 29 qershor 2021; dhe
- Seanca e 52-të: 16 shtator 2021.

3. Jurisprudenca

3.1. Hyrje

Paneli vazhdoi me zhvillimin e jurisprudencës së vet dhe nxori një numër vendimesh rreth meritave dhe pranueshmërinë gjatë periudhës raportuese.

Duke vepruar kështu, Paneli u mbështet gjerësisht në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore (KEDNj), jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GjEDNj), por gjithashtu nxori mësime nga instrumente të tjera, si dhe vendime dhe deklarata të organeve monitoruese përkatëse. Kjo përfshinë konventat ndndërkombëtare të të drejtave të njeriut të Kombeve të Bashkuara dhe mekanizma monitorues përkatës, Konventa Ndër-Amerikane e të Drejtave të Njeriut (dhe çështja e lidhur me të), si dhe jurisprudencën e Panelit Këshilldhënes për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara, jurisprudencën e vet, si dhe ligjin në fuqi në Kosovë.

Për më tepër, Paneli nxori një numër vendimesh përcjellëse të vendimeve të mëparshme në lidhje me meritat. Aftësia e Panelit për të përcejllur rekomandimet e veta është një element i rëndësishëm i infrastrukturës normative të tij, për aq sa i lejon që të sigurojë që rekomandimet të merren në konsideratë siç duhet dhe plotësisht nga Misioni dhe se ato zbatohen në masën më të madhe të mundshme.

3.2. Vendimet për meritat

Paneli ka lëshuar nëntë (9) vendime rreth meritave gjatë vitit 2021.

Seanca e Panelit e datës 26 mars 2021

- Lënda 2016-15 Dragan Janačković kundër EULEX-it. Më 26 mars 2021, Paneli miratoi vendimin dhe gjetjet e tij. Në atë vendim, Paneli përcaktoi që EULEX-i kishte dështuar të kryejë një hetim efektiv rreth zhdukjes së anëtarit të ngushtë të familjes së ankuesit dhe kishte dështuar ta mbante ankuesin të informuar për zhvillimet përkatëse në atë rast. Si rezultat, Paneli vendosi që Misioni ishte përgjegjës për shkeljen e të drejtave të ankuesit nën pjesët procedurale të së drejtës së ankuesit për jetën, të garantuar me nenin 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe për shkeljen e të drejtës së ankuesit për mos t'iu nënshtruar trajtimit çnjerëzor ose poshtërues, siç garantohet nga neni 3 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Paneli gjithashtu përcaktoi që Misioni ishte përgjegjës për dështimin për t'i siguruar ankuesit një mjet të efektshëm juridik, në kundërshtim me nenin 13 të Konventës. Paneli i bëri disa rekomandime shefit të Misionit të EULEX-it, duke përfshirë që t'i pyes autoritetet se çfarë hapash po ndërmerren për të hetuar këtë rast, dhe për t'iu theksuar autoriteteve rëndësinë e të drejtave të viktimave për të vërtetën dhe për t'u informuar për rrjedhën e përgjithshme të hetimit. Paneli gjithashtu ftoi shefin e Misionit që t'i drejtohet ankuesit me qëllim që të kërkojë gjetjen e një mjeti juridik për shkeljen e të drejtave të tij. Zbatimi i atyre rekomandimeve nga ana e Misionit është ende në pritje.

- Lënda 2016-20 Dragica Čerimi kundër EULEX-it. Më 26 mars 2021, Paneli miratoi vendimin e tij mbi pranueshmërinë dhe gjetjet. Pasi e gjeti rastin të pranueshëm, Paneli përcaktoj që EULEX-i kishte dështuar të kryejë një hetim efektiv në zhdukjen e anëtarit të ngushtë të familjes së ankuesit dhe kishte dështuar ta mbante ankuesin të informuar për zhvillimet përkatëse në rast. Për më tepër, Paneli vuri në dukje se fakti që trupi i anëtarit të ngushtë të familjes ishte identifikuar dhe kthyer në familje nuk e shfajësonte EULEX-in nga detyrimet e tij. Si rezultat, Paneli përcaktoi që Misioni ishte përgjegjës për një shkelje nën pjesën procedurale të së drejtës së ankuesit për jetën, siç garantohet nga neni 2 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe për shkeljen e të drejtës së ankuesit për mos t'iu nënshtruar trajtimit çnjerëzor ose poshtërues, siç garantohet nga neni 3 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Paneli gjithashtu përcaktoi që Misioni ishte përgjegjës për dështimin për t'i siguruar ankuesit një mjet të efektshëm juridik, në kundërshtim me nenin 13 të Konventës. Paneli i bëri disa rekomandime shefit të Misionit të EULEX-it, duke përfshirë që t'i pyes autoritetet se çfarë hapash po ndërmerren për të hetuar këtë rast, dhe për t'iu

theksuar autoriteteve rëndësinë e të drejtave të viktimave për të vërtetën dhe për t'u informuar për rrjedhën e përgjithshme të hetimit. Paneli gjithashtu ftoi shefin e Misionit që ta kontaktoj ankuesen me qëllim që të kërkojë gjetjen e një mjeti juridik për shkeljen e të drejtave të saj. Zbatimi i Misionit të atyre rekomandimeve është në pritje.

- Lënda 2016-21 Milanka čitlučanin kundër EULEX-it. Më 26 mars 2021, Paneli miratoi vendimin dhe gjetjet e tij. Në atë vendim, Paneli përcaktoi që EULEX-i kishte dështuar të kryejë një hetim efektiv rreth zhdukjes së anëtarit të ngushtë të familjes së ankuesit dhe kishte dështuar ta mbante ankuesin të informuar për zhvillimet përkatëse në atë rast. Si rezultat, Paneli vendosi që Misioni ishte përgjegjës për shkeljen e të drejtave të ankuesit nën pjesët procedurale të së drejtës së ankuesit për jetën, të garantuar me nenin 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe për shkeljen e të drejtës së ankuesit për mos t'iu nënshtruar trajtimit çnjerëzor ose poshtërues, siç garantohet nga neni 3 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Paneli i bëri disa rekomandime shefit të Misionit të EULEX-it, duke përfshirë që t'i pyes autoritetet se çfarë hapash po ndërmerren për të hetuar këtë rast, dhe për t'iu theksuar autoriteteve rëndësinë e të drejtave të viktimave për të vërtetën dhe për t'u informuar për rrjedhën e përgjithshme të hetimit. Paneli gjithashtu ftoi shefin e Misionit që ta kontaktoj ankuesen me qëllim që të kërkojë gjetjen e një mjeti juridik për shkeljen e të drejtave të saj. Zbatimi i atyre rekomandimeve nga ana e Misionit është ende në pritje.

- Lënda 2016-30 Svetlana Đorđević kundër EULEX-it. Më 26 mars 2021, Paneli miratoi vendimin e tij mbi pranueshmërinë dhe gjetjet. Pasi e gjeti rastin të pranueshëm, Paneli vendosi që EULEX kishte dështuar të kryejë një hetim efektiv në zhdukjen e anëtarit të ngushtë të familjes së ankuesit dhe kishte dështuar ta mbante ankuesin të informuar për zhvillimet përkatëse në rast. Për më tepër, Paneli vuri në dukje se fakti që trupi i anëtarit të ngushtë të familjes ishte identifikuar dhe kthyer në familje nuk e shfajësonte EULEX-in nga detyrimet e tij. Si rezultat, Paneli vendosi që Misioni ishte përgjegjës për shkeljen e të drejtave të ankuesit nën pjesët procedurale të së drejtës së ankuesit për jetën, të garantuar me nenin 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe për shkeljen e të drejtës së ankuesit për mos t'iu nënshtruar trajtimit çnjerëzor ose poshtërues, siç garantohet nga neni 3 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Paneli i bëri disa rekomandime shefit të Misionit të EULEX-it, duke përfshirë që t'i pyes autoritetet se çfarë hapash po ndërmerren për të hetuar këtë rast, dhe për t'iu theksuar autoriteteve rëndësinë e të drejtave të viktimave për të vërtetën dhe për t'u informuar për rrjedhën e përgjithshme të hetimit. Paneli gjithashtu ftoi shefin e Misionit që ta kontaktoj ankuesen me qëllim që të kërkojë gjetjen e një mjeti juridik për shkeljen e të drejtave të saj. Zbatimi i atyre rekomandimeve nga ana e Misionit është ende në pritje.

Seanca e Panelit e datës 29 qershor 2021

- Lënda 2016-16 Dobrivoje Vukmirović kundër EULEX-it. Më 29 qershor 2021, Paneli ka lëshuar Vendimin dhe Gjetjet. Në vendimin e tij, Paneli vendosi që EULEX-i kishte dështuar të kryejë hetim efektiv për zhdukjen e anëtarit të ngushtë të familjes së ankuesit dhe kishte dështuar ta mbante të informuar ankuesin. Si rezultat, Paneli gjeti që Misioni ishte përgjegjës për një shkelje në pjesën procedurale të së drejtës së ankuesit për jetë, të garantuar me nenin 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe për shkeljen e së drejtës së ankuesit për mos t'iu nënshtruar trajtimeve çnjerëzore e poshtëruese, siç garantohet me nenin 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Paneli gjithashtu gjeti që Misioni ishte përgjegjës që nuk i ka siguruar ankuesit një mjet efektiv juridik, në kundërshtim me nenin 13 të Konventës. Paneli i bëri disa rekomandime shefit të Misionit të EULEX-it, duke përfshirë që t'i pyes autoritetet se çfarë hapash janë duke ndërmarrë për të hetuar rastin dhe që t'u theksojë autoriteteve rëndësinë e të drejtave të viktimës për të vërtetën dhe që të informohet për rrjedhën e

përgjithshme të hetimi. Paneli gjithashtu ftoi shefin e Misionit të kontaktojë ankuesin në mënyrë që të gjejë një mjet juridik për shkeljen e të drejtave të tij. Zbatimi i Misionit i atyre rekomandimeve është ende në pritje.

- Lënda 2016-19 Dušan Milosavljević kundër EULEX-it. Më 29 qershor 2021, Paneli miratoi vendimin e tij mbi pranueshmërinë dhe meritat. Në vendimin e tij, Paneli përcaktoi që EULEX-i nuk kishte kryer ndonjë hetim efektiv për zhdukjen e anëtarit të ngushtë të familjes së ankuesit dhe nuk kishte informuar ankuesin. Si rezultat, Paneli vendosi që Misioni ishte përgjegjës për shkelje të pjesës procedurale të së drejtës së ankuesit për jetën, të garantuar me nenin 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe për shkeljen e së drejtës së ankuesit për mos t'iu nënshtruar trajtimi çnjerëzor ose poshtërues, siç garantohet nga neni 3 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Paneli i bëri disa rekomandime shefit të Misionit të EULEX-it, duke përfshirë që t'i pyes autoritetet se çfarë hapash janë duke ndërmarrë për të hetuar rastin dhe që t'u theksojë autoriteteve rëndësinë e të drejtave të viktimës për të vërtetën dhe që të informohet për rrjedhën e përgjithshme të hetimi. Paneli gjithashtu ftoi shefin e Misionit të kontaktojë ankuesin në mënyrë që të gjejë një mjet juridik për shkeljen e të drejtave të saj. Zbatimi nga ana e Misionit e atyre rekomandimeve është ende në pritje.

- Lënda 2016-22 Radmila Šapić kundër EULEX-it. Më 29 qershor 2021, Paneli ka lëshuar Vendimin dhe Gjetjet. Në vendimin e tij, Paneli vendosi që EULEX-i kishte dështuar të kryejë hetim efektiv për zhdukjen e anëtarit të ngushtë të familjes së ankuesit dhe kishte dështuar ta mbante të informuar ankuesin. Si rezultat, Paneli gjeti që Misioni ishte përgjegjës për një shkelje në pjesën procedurale të së drejtës së ankuesit për jetë, të garantuar me nenin 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe për shkeljen e së drejtës së ankuesit për mos t'iu nënshtruar trajtimeve çnjerëzore e poshtëruese, siç garantohet me nenin 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Paneli i bëri disa rekomandime shefit të Misionit të EULEX-it, duke përfshirë që t'i pyes autoritetet se çfarë hapash janë duke u ndërmarrë për të hetuar rastin dhe që t'u theksojë autoriteteve rëndësinë e të drejtave të viktimës për të vërtetën dhe që të informohet për rrjedhën e përgjithshme të hetimi. Paneli gjithashtu ftoi shefin e Misionit të kontaktojë ankuesin në mënyrë që të gjejë një mjet juridik për shkeljen e të drejtave të tij. Zbatimi i Misionit i atyre rekomandimeve është ende në pritje.

- Lënda 2016-32 Biljana Đorđević kundër EULEX-it. Më 29 qershor 2021, Paneli mori vendimin dhe gjetjet e tij. Në vendimin e tij, Paneli vendosi që EULEX-i kishte dështuar të kryejë hetim efektiv për zhdukjen e anëtarit të ngushtë të familjes së ankuesit dhe kishte dështuar ta mbante të informuar ankuesin. Si rezultat, Paneli gjeti që Misioni ishte përgjegjës për një shkelje në pjesën procedurale të së drejtës së ankuesit për jetë, të garantuar me nenin 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe për shkeljen e së drejtës së ankuesit për mos t'iu nënshtruar trajtimeve çnjerëzore e poshtëruese, siç garantohet me nenin 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Paneli i bëri disa rekomandime shefit të Misionit të EULEX-it, duke përfshirë që t'i pyes autoritetet se çfarë hapash janë duke u ndërmarrë për të hetuar rastin dhe që t'u theksojë autoriteteve rëndësinë e të drejtave të viktimës për të vërtetën dhe që të informohet për rrjedhën e përgjithshme të hetimi. Paneli gjithashtu ftoi shefin e Misionit të kontaktojë ankuesin në mënyrë që të gjejë një mjet juridik për shkeljen e të drejtave të tij. Zbatimi i Misionit i atyre rekomandimeve është ende në pritje.

Seanca e Panelit e datës 16 shtator 2021

- Lënda 2018-01 Y.B.2 kundër EULEX-it. Më 16 shtator 2021, Paneli miratoi vendimin e tij mbi pranueshmërinë dhe meritat. Në vendimin e tij, Paneli hodhi poshtë kërkesën e ankuesit për masa të përkohshme. Paneli gjithashtu hodhi poshtë kërkesën e Misionit për ta nxjerrë lëndën nga lista e tij e lëndëve. Lidhur me ankesën për shkelje të së drejtës për prezumimin e pafajësisë, të mbrojtur me nenin 6(2) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Paneli e hodhi poshtë

këtë ankesë si qartazi të pabazuar. Lidhur me ankesën për shkelje të së drejtës për respektimin e jetës private, e mbrojtur nga neni 8 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Paneli konstatoi se deklaratat e bëra nga prokurori i EULEX-it në intervistën televizive përbënin ndërhyrje të pajustifikuar në reputacionin e ankuesit dhe në këtë mënyrë kishte shkelur nenin 8. Paneli ftoi Misionin të bëjë një deklaratë publike duke pranuar se rrethanat e rastit përbënin një shkelje të të drejtave të ankuesit si rezultat i veprimeve që i atribuohen EULEX-it në kryerjen e mandati i tij ekzekutiv.

3.3. Vendimet e pranueshmërisë

Paneli ka marrë gjashtë (6)) vendime mbi pranueshmëri në vitin 2021.

Seanca e Panelit e datës 26 mars 2021

Paneli ka shpallur tre (3) ankesë të papranueshme gjatë seancës.

- Lënda 2016-20 Dragica Čerimi kundër EULEX-it. (Shih më sipër vendimet rreth meritave).
- Lënda 2016-21 Milanka čitlučanin kundër EULEX-it. (Shih më sipër vendimet rreth meritave).
- Lënda 2016-30 Svetlana Đorđević kundër EULEX-it. (Shih më sipër vendimet rreth meritave).

Seanca e Panelit e datës 29 qershor 2021

- Lënda 2016-19 Dušan Milosavljević kundër EULEX-it. (Shih më sipër vendimet rreth meritave).
- Lënda 2016-32 Biljana Đorđević kundër EULEX-it. (Shih më sipër vendimet rreth meritave).

Seanca e Panelit e datës 2016 shtator 2021

Paneli ka shpallur një (1) ankesë të papranueshme gjatë seancës.

- Lënda 2018-01 Y.B.2 kundër EULEX-it. (Shih më sipër vendimet rreth meritave).

3.4. Vendimet rreth kërkesave për rishqyrtim

Paneli nuk ka marrë asnjë kërkesë për rishqyrtim gjatë vitit 2021.

3.5. Vendimet pasuese

Paneli ka marrë gjashtë (6) vendime pasuese gjatë vitit 2021.

Seanca e Panelit e datës 12 shkurt 2021

- Lënda 2016-13 Miomir Krivokapić kundër EULEX-it. Më 12 shkurt 2021, Paneli miratoi një vendim përcjellës për zbatimin e rekomandimeve të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Si çështje paraprake, Paneli theksoi se të drejtat e ankuesit në rastin aktual duket se ende janë duke u shkelur pasi që rasti i të afërmit të tij të zhdukur mbetet i pahetuar. Paneli konsideroi se hapat e deritanishëm të ndërmarrë ose të propozuar nga Misioni për të adresuar gjetjet dhe rekomandimet e Panelit nuk ofrojnë përgjigje adekuate

ose efektive ndaj shkeljes së të drejtave të ankuesit. Paneli ftoi Misionin që të shqyrtojë edhe një herë rekomandimet e Panelit që nuk janë respektuar dhe të informojë Panelin për rezultatin e këtyre konsideratave. Paneli më tej ftoi Misionin që të miratojë masa në përgjigje të rekomandimeve të Panelit që pasqyrojnë me të vërtetë thellësinë e përkushtimit të Misionit për të respektuar standardet e të drejtave të njeriut dhe për të riparuar dëmin serioz që i është shkaktuar ankuesit në këtë rast. Paneli vendosi ta mbajë të hapur rastin aktual për përcjellje të mëtejshme të mundshme.

- Lënda 2016-14 Milan Ađančić kundër EULEX-it. Më 12 shkurt 2021, Paneli miratoi një vendim përcjellës për zbatimin e rekomandimeve të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Si çështje paraprake, Paneli theksoi se të drejtat e ankuesit në rastin aktual duket se ende janë shkelur pasi që rasti i të afërmit të tij të zhdukur mbetet i pahetuar. Paneli konsideroi se hapat e deritanishëm të ndërmarrë ose të propozuar nga Misioni për të adresuar gjetjet dhe rekomandimet e Panelit nuk ofrojnë një përgjigje adekuate ose efektive ndaj shkeljes së të drejtave të ankuesit. Paneli ftoi Misionin që të shqyrtojë edhe një herë rekomandimet e Panelit që nuk janë respektuar dhe të informojë Panelin për rezultatin e këtyre konsideratave. Paneli më tej ftoi Misionin që të miratojë masa në përgjigje të rekomandimeve të Panelit që pasqyrojnë me të vërtetë thellësinë e përkushtimit të Misionit për të respektuar standardet e të drejtave të njeriut dhe për të riparuar dëmin serioz që i është shkaktuar ankuesit në këtë rast. Paneli vendosi ta mbajë të hapur rastin aktual për ndjekje të mëtejshme të mundshme.

Seanca e Panelit e datës 29 prill 2021

- Lënda 2016-09 Slobodan Trifunovic kundër EULEX-it. Më 29 prill 2021, Paneli miratoi një vendim përcjellës për zbatimin e rekomandimeve të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Si çështje paraprake, Paneli theksoi se të drejtat e ankuesit në rastin aktual duket se ende janë shkelur pasi që rasti i të afërmit të tij të zhdukur mbetet i pahetuar. Paneli konsideroi se hapat e deritanishëm të ndërmarrë ose të propozuar nga Misioni për të adresuar gjetjet dhe rekomandimet e Panelit nuk ofrojnë përgjigje adekuate ose efektive ndaj shkeljes së të drejtave të ankuesit. Paneli ftoi Misionin që të shqyrtojë edhe një herë rekomandimet e Panelit që nuk janë respektuar dhe të informojë Panelin për rezultatin e këtyre konsideratave. Paneli më tej ftoi Misionin që të miratojë masa në përgjigje të rekomandimeve të Panelit që pasqyrojnë me të vërtetë thellësinë e përkushtimit të Misionit për të respektuar standardet e të drejtave të njeriut dhe për të riparuar dëmin serioz që i është shkaktuar ankuesit në këtë rast. Paneli vendosi ta mbajë të hapur rastin aktual për ndjekje të mëtejshme të mundshme.

- Lënda 2016-10 Dragiša Kostić kundër EULEX-it. Më 29 prill 2021, Paneli miratoi një vendim përcjellës për zbatimin e rekomandimeve të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Si çështje paraprake, Paneli theksoi se të drejtat e ankuesit në rastin aktual duket se ende janë shkelur pasi që rasti i të afërmit të tij të zhdukur mbetet i pahetuar. Paneli konsideroi se hapat e deritanishëm të ndërmarrë ose të propozuar nga Misioni për të adresuar gjetjet dhe rekomandimet e Panelit nuk ofrojnë një përgjigje adekuate ose efektive ndaj shkeljes së të drejtave të ankuesit. Paneli ftoi Misionin që të shqyrtojë edhe një herë rekomandimet e Panelit që nuk janë respektuar dhe të informojë Panelin për rezultatin e këtyre konsideratave. Paneli më tej ftoi Misionin që të miratojë masa në përgjigje të rekomandimeve të Panelit që pasqyrojnë me të vërtetë thellësinë e përkushtimit të Misionit për të respektuar standardet e të drejtave të njeriut dhe për të riparuar dëmin serioz që i është shkaktuar ankuesit në këtë rast. Paneli vendosi ta mbajë të hapur rastin aktual për ndjekje të mëtejshme të mundshme.

- Lënda 2019-01 G.T. kundër EULEX-it. Më 29 prill 2021, Paneli miratoi një Vendim Vazhdues për zbatimin e rekomandimeve të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Paneli vuri në dukje se Misioni kishte ndjekur dhe zbatuar disa, por jo të gjitha rekomandimet e Panelit. Në veçanti, Paneli konsideroi se Misioni kishte dështuar të pranonte shkeljen e të drejtave të ankesës dhe nuk kishte kontaktuar drejtpërdrejt me ankuesin në lidhje me përcaktimin e nevojës për siguri shtesë që rrjedh nga dëshmia e ankuesit në Serbi. Paneli e ftoi Misionin edhe një herë që t'i respektojë këto dy rekomandime. Paneli vendosi ta mbajë të hapur rastin aktual për ndjekje të mëtejshme të mundshme.

Seanca e Panelit e datës 16 shtator 2021

- Lënda 2019-01 G.T. kundër EULEX-it. Më 16 shtator 2021, Paneli miratoi vendimin e dytë për zbatimin e rekomandimeve të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Paneli vuri në dukje se Misioni kishte ndjekur dhe zbatuar disa, por jo të gjitha rekomandimet e Panelit. Në veçanti, Paneli konsideroi se Misioni kishte dështuar të pranonte shkeljen e të drejtave të ankesës dhe nuk kishte kontaktuar drejtpërdrejt me ankuesin në lidhje me përcaktimin e nevojës për siguri shtesë që rrjedh nga dëshmia e ankuesit në Serbi. Paneli shprehu keqardhje që Misioni edhe një herë kishte dështuar të përmbushë këto dy rekomandime. Për më tepër, Paneli përsëriti se Misioni është përgjegjës për ofrimin e një mjeti juridik efektiv për shkeljen e të drejtave të njeriut që ka kryer në rastin konkret, dhe se Misioni nuk mund t'i delegojë obligimet e tij për të drejtat e njeriut palëve të treta. Paneli kërkoi nga Misioni që të qarkullojë këtë vendim tek zyrtarët përkatës të Misionit dhe autoritetet jashtë tij. Paneli vendosi të mbyllë shqyrtimin e rastit.

4. Aktivitetet e tjera të Panelit

4.1. Takimet

Më 22 prill 2021, Paneli u takua përmes video-konferencës me z. Lars-Gunnar Wigemark, shef i Misionit të EULEX-it në Kosovë. Tema e këtij takimi në mes të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut (PShDNj) dhe shefit të Misionit të EULEX-it ishte diskutimi i raportit të PShDNj-së: *"Llogaridhënia për të Drejtat e Njeriut në kontekstin e Misionit të EULEX-it në Kosovë për Sundim të Ligjit – Vlerësimi i Përkohshëm"*, të cilin PShDNj-ja ia kishte dhënë shefit të Misionit më 31 mars 2021 (shih gjithashtu seksionin 4.5 më poshtë). Ky takim gjithashtu i ofroi shefit të Misionit një mundësi për të falënderuar anëtarin kryesues të Panelit në largim, Dr Guénaël Mettraux.

Më 23 shtator 2021, Paneli u takua përmes video-konferencës me z. Lars-Gunnar Wigemark, shef i Misionit të EULEX-it në Kosovë. Tema e këtij takimi në mes të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut (PShDNj) dhe shefit të Misionit të EULEX-it ishte diskutimi i çfarëdo çështjeje të pazgjidhur para largimit nga misioni i anëtares së atëhershme kryesuese të Panelit, znj. Anna Autio.

4.2. Fushata informuese e vitit 2021

Koncept Dokumenti i Llogaridhënies i datës 29 tetor 2009 theksoi, ndër të tjera, në paragrafin E, se, "…EULEX-i Kosovë do të sigurojë një shpërndarje të duhur të informacionit publik për Panelin dhe punën e tij…"
Komandanti i Operacioneve Civile, në udhëzimin e tij të datës 13 nëntor 2009, deklaroi, në lidhje me Panelin, se Udhërrëfyesi për Aftësinë e Sjelljes së Planifikimit Civil duhet të përfshijë, "… përgatitjen e një fushate gjithëpërfshirëse informuese".

4.2.1. Takimet me organizatat kosovare

Më 23 shkurt 2021, kryesuesi i Sekretariatit të Panelit u takua me z. Negovan Mavric, bashkërendues i sapoemëruar serb i Qendrës Burimore të Personave të Zhdukur (QKMP). Ata diskutuan statusin e rasteve të personave të zhdukur në pritje të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, dhe rikonfirmuan rëndësinë e rolit të MPRC-së si kanal për korrespodencë me ankuesit që banojnë në komunat veriore të Kosovës, ku operimet normale postare nuk janë të disponueshme.

4.2.2. Video Informative

Pas videos së parë informuese të publikuar në Ditën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut 2020, në tremujorin e dytë të 2021 Paneli i Shqyrtimit të të Drejtave të Njeriut publikoi dy video të shkurtra informuese shtesë. Qëllimi i këtyre videove është informojë në lidhje me Panelin dhe punën e tij, në veçanti tek popullata vendore në Kosovë, në përputhje me mandatin e Panelit. Të dyja videot janë publikuar në anglisht, shqip dhe serbisht.

Në prill 2021, Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut publikoi videon e tij të dytë informuese. Kjo video e dytë shpjegon me fjalë të thjeshta, *"Si mund të bëni një ankesë në Panelin e Shqyrtimit të të Drejtave të Njeriut?"*

Në maj 2021, Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut publikoi një video të tretë informuese. Kjo video e tretë përshkruan, *"Çfarë bën* Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut *me ankesën tuaj?"*

Këto dy video u publikuan në faqen e Panelit, faqen në Facebook dhe faqen LinkedIn. Të dyja videot mund të gjenden në këtë vegzë: https://hrrp.eu/alb/videos.php.

4.3. Trajnimi hyrës

Pjesëtarët e sapoardhur të Misionit hyjnë në një trajnin hyrës që përfshin një komponent në lidhje me mandatin dhe funksionimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Sekretariati ka ofruar materiale bazike në mbështetje të këtij trajnimi. Ky proces është i dobishëm për t'i njoftuar anëtarët e ardhshëm të stafit rreth mandatit të Panelit, për të nënvizuar më tej rëndësinë e respektimit të të drejtave të njeriut për EULEX-in Kosovë dhe që anëtarët e stafit të EULEX-it të kenë njohuri më shumë për Panelin në fushën e operacioneve të EULEX-it Kosovë. Ky është një element i rëndësishëm në procesin që të sigurohet se stafi i Misionit të ndërgjegjësohet rreth detyrimeve të veta ndaj të drejtave të njeriut dhe të jenë në gjendje të veprojnë në përputhje me të.

4.4. Faqja e internetit e PShDNj-së

Sekretariati e mirëmban faqen e internetit të Panelit: https://hrrp.eu/alb/. Kjo faqe përmban informata lidhur me mandatin, procedurat dhe punën e Panelit, si dhe informata rregullisht të përditësuara lidhur me vendimet e Panelit, si dhe listën e lëndëve që janë ende të pazgjidhura dhe ato të përfunduara.

Aty ofrohet qasje e lehtë në tabelën e jurisprudencës së Panelit. Aty paraqitet praktika gjyqësore në rritje e sipër e Panelit sipas çështjes së lëndëve, si në bazë të pranueshmërisë dhe përmbajtjes së rasteve që janë në shqyrtim. Ajo është krijuar, mes tjerash, për të siguruar qasje të gatshme dhe të lehtë në praktikën gjyqësore të Panelit për ankuesit, juristët dhe për opinionin e gjerë: (https://hrrp.eu/alb/jurisprudence.php).

Paneli gjithashtu ka ofruar disa "Shënime të jurisprudencë" që përmbledhin sipas temave disa nga aspektet më të rëndësishme të jurisprudencës së tij (http://hrrp.eu/Case-Law_Notes.php).

Faqja e internetit gjithashtu ofron informacione për:

Standardet e zbatueshme të të drejtave të njeriut: (http://www.hrrp.eu/relevant-rights.php);

Formularët dhe udhëzimet për parashtrimin e ankesave: (http://hrrp.eu/filing%20complaints.php);

Po ashtu, Paneli e ka profilin e tij në Facebook: Human Rights Review Panel;

Informatat e mësipërme janë në dispozicion në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe.

4.5 Llogaridhënia e të drejtave të njeriut në kontekstin e misionit të EULEX-it në Kosovë për Sundimin e Ligjit – Vlerësimi i Përkohshëm

Në prill 2021, Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut ka publikuar një raport të titulluar "Përgjegjësia për të drejtat e njeriut në kontekstin e misionit të EULEX-it në Kosovë për Sundimin e Ligjit – Vlerësimi i Përkohshëëm".

Qëllimi i këtij raporti është i trefishtë: me siguru një shpjegim të hollësishme të punës së Panelit deri më tani; me siguru mësime të marra - pozitive dhe negative - dhe rekomandime për përgjegjësinë e të drejtave të njeriut për çdo mision të ardhshëm ndërkombëtar të sundimit të ligjit; dhe, m'i nxjerrë në pah fushat e përmirësimit për misionin e EULEX-it Kosovë për sa i përket përgjegjësisë së tij ndaj të drejtave të njeriut për pjesën e mbetur të mandatit të tij.

Raporti ka për qëllim të jetë me rëndësi për Misionin dhe autoritetet e BE-së, shtetet anëtare të BE-së dhe shtetet e treta kontribuese, autoritetet e Kosovës, komunitetin diplomatik, organizata të tjera ndërqeveritare, studiues dhe praktikues të të drejtave të njeriut, dhe shoqërinë civile si në Kosovë ashtu edhe ndërkombëtarisht.

Në diskutimin e parë të këtij raporti të vlerësimit të ndërmjetëm, Misioni hodhi poshtë shumicën e konsideratave të Panelit. Paneli mbetet i angazhuar në këtë çështje. i konfiskuar

5. Paneli dhe Sekretariati

5.1. Anëtarët e Panelit

Sipas Konceptit të Llogaridhënies dhe Rregullores së Punës së Panelit, Paneli përbëhet prej katër anëtarëve; dy anëtarë të jashtëm dhe dy anëtarë të EULEX-it, prej të cilëve njëri është zëvendës i tjetrit. Para rishikimit të mandatit në qershor të vitit 2018, të dy anëtarët e EULEX-it ishin anëtarë të personelit të EULEX-it të emëruar për të punuar si gjykatës në sistemin gjyqësor të Kosovës. Pas rishikimit të mandatit, dy anëtarët e EULEX-it janë anëtarë të personelit të Shtyllës së Monitorimit të EULEX-it.

Përbërja e Panelit ndryshoi ndjeshëm gjatë vitit 2021. Më 30 mars 2021, anëtarja e Panelit të EULEX-it, znj. Anna Bednarek, dha dorëheqje. Më 30 prill 2021, anëtari kryesues i Panelit, Dr Guénaël Mettraux, dha dorëheqjen dhe pozicioni i tij si anëtar kryesues iu transferua zyrtarisht znj. Anna Autio. Më pas, më 24 shtator 2021, znj. Autio gjithashtu dha dorëheqjen.

Pas një procesi të jashtëm rekrutimi, më 6 dhjetor 2021, znj. Snježana Bokulić u emërua anëtare e jashtme e Panelit. Një proces shtesë rekrutimi filloi në dhjetor 2021 për të identifikuar një anëtar të dytë të panelit të jashtëm.

5.1.1. Ndërhyrja e Misionit në pavarësinë e Panelit

Për fat të keq, Paneli duhet të raportojë për ndërhyrjen e padrejtë të Misionit në pavarësinë dhe paanshmërinë e Panelit gjatë periudhës raportuese. Ndërhyrja ka të bëjë me rekrutimin e anëtarit të jashtëm të Panelit.

Gjatë procedurës së përzgjedhjes për anëtarin e jashtëm të Panelit, Misioni fillimisht tregoi se do të vendoste një vëzhgues në panelin përzgjedhës. Paneli e kundërshtoi këtë duke i dërguar një letër zyrtare shefit të Misionit, duke i kujtuar atij rëndësinë e respektimit të pavarësisë së Panelit në procesin e përzgjedhjes dhe duke kërkuar nga Misioni që të përmbahet nga vendosja e një vëzhguesi në panelin përzgjedhës. Më pas, Misioni e vonoi procedimin e përzgjedhjes duke mos i bashkërenduar nga paneli përzgjedhës listën e kandidatëve të suksesshëm pas testimit me shkrim dhe duke mos i bashkërenduar intervistat. Procesi i përzgjedhjes kishte një shkallë urgjence të bashkangjitur me të, pasi që Paneli rrezikohej të ishte pa anëtarë të jashtëm dhe për këtë arsye nuk ishte në gjendje të funksiononte. Misioni e bëri këtë për një periudhë prej dy javësh, pa asnjë arsye të qartë, derisa iu përgjigj shqetësimeve të ngritura duke u tërhequr nga vendosja e një vëzhguesi në panelin përzgjedhës dhe duke lejuar vazhdimin e procedurës së përzgjedhjes. Shefi i Misionit, në përgjigjen e tij, siguroi se Misioni do të vazhdojë të sigurohet që PShDNj-ja të mund të ushtrojë në mënyrë të pavarur funksionet e tij, por në të njëjtën kohë shprehu qëndrimin e kundërt të Misionit se prania e vëzhguesve në panelet përzgjedhëse të PShDNj-së nuk ka asnjë ndikim në ushtrimin e pavarur të funksioneve të PShDNj-së.

Pas përgjigjes së shefit të Misionit, procesi i përzgjedhjes u përmbyll me sukses dhe një anëtar i jashtëm i Panelit u zgjodh dhe më vonë u emërua. Përgjigja nga Shefi i Misionit dhe këndvështrimi i kundërt i Misionit është ende shqetësues në lidhje me proceset e ardhshme të përzgjedhjes.

Paneli e përfshiu këtë episod sepse është i rëndësishëm për qëllimet e pavarësisë së Panelit, pasi janë anëtarët e jashtëm të panelit (të cilët përfshijnë në mënyrë tautomatike kryesuesin), të cilët përfitojnë nga pavarësia dhe paanësia e plotë, dhe gjithashtu sepse në atë kohë, kanëtari kryesues ishte i vetmi anëtar i jashtëm.

Më 23 shtator 2021, gjatë video-konferencës ndërmjet Panelit dhe shefit të Misionit, Paneli përsëri ngriti shqetësimet e tij në lidhje me rekrutimin dhe përzgjedhjen e anëtarëve të rinj të Panelit. Shefi i Misionit vuri në dukje shqetësimet e Panelit dhe tha se kjo në asnjë mënyrë nuk kishte për qëllim ndërhyrje në pavarësinë e Panelit dhe shprehu keqardhje nëse kjo përshtypje që ishte krijuar.

Meqenëse një pozitë e anëtarit të Panelit të jashtëm mbetet i lirë, është e rëndësishme që procedurat e ardhshme të përzgjedhjes të lejohen të kryhen pa ndërhyrje nga Misioni.

Si informatë shtesë, shefi i Misionit emëron zyrtarisht të gjithë anëtarët e Panelit, duke përfshirë anëtarët e jashtëm. Megjithatë, për të ruajtur pavarësinë e Panelit, zgjedhjet duhet të kryhen dhe janë bërë në të kaluarën pa një përfshirje dhe ndërhyrje të tillë nga Misioni.

5.1.2. Kryesuesi i Panelit

Pas dorëheqjeve nga Paneli i anëtarëve kryesues të mëparshëm Dr. Guénaël Mettraux dhe, më pas, znj. Anna Autio, dhe pas emërimit të saj në Panel, znj. Snježana Bokulić u bë ushtruese e detyrës së kryesueses së Panelit.

5.1.3. Anëtarët deri më 31 dhjetor 2021

Znj. Snježana Bokulić – Anëtare e Jashtme, ushtruesee e detyrës së kryesueses, e emëruar më 6 dhjetor 2021.

Snježana Bokulić është avokate e të drejtave të njeriut, e cila ka punuar në organizata ndërkombëtare qeveritare dhe joqeveritare për më shumë se dy dekada duke zbatuar ligjin ndërkombëtar të të drejtave të njeriut për të avancuar respektimin e të drejtave të njeriut të komuniteteve në pesë kontinente. Është e specializuar në të drejtat e pakicave, të drejtat e popujve indigjenë, mosdiskriminimin dhe ndërsektorialitetin. Ajo ka punuar gjerësisht në llogaridhënien e organizatave dhe krijimin e mekanizmave të ankesave të organizatave.

Si shefe e departamentit të të drejtave të njeriut të OSBE/ODIHR-it, znj. Bokulić ka drejtuar misione të vlerësimit të të drejtave të njeriut të ODIHR-it në Ukrainë dhe në Bazën Detare të Guantanamos, si dhe misionin e monitorimit të gjykimit në Bjellorusi. Ajo ka udhëhequr programin e monitorimit të lirisë së tubimeve paqësore të ODIHR-it dhe ka udhëhequr hartimin e udhëzimeve të ODIHR-it për mbrojtjen e mbrojtësve të të drejtave të njeriut. Ajo është kryetare e Panelit të Pavarur për Shqyrtim në Accountable Now, një platformë globale e anëtarësimit që synon të rrisë llogaridhënien në organizata të shoqërisë civile, dhe është anëtare e Këshillit të the3million, organizatës më të madhe me bazë në komunitet të qytetarëve të BE-së në Mbretërinë e Bashkuar.

Znj. Bokulić mban titullin e masterit në të drejtën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut nga Universiteti i Essex-it, poashtu mban titullin e masterit në studimet e Evropës Juglindore nga Universiteti i Evropës Qendrore dhe diplomë të studimeve themelore nga Kolegji Notre Dame në Maryland.

Shefi i Misionit të EULEX-it ka emëruar znj. Bokulić anëtare të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut më 6 dhjetor.

Z. Petko Petkov – Anëtar zëvendësues i EULEX-it, i emëruar më 19 dhjetor 2018.

Z. Petko Petkov ka diplomuar në Universitetin e Sofjes me titullin magjistër i juridikut. Ai ka shërbyer gjykatës i ri në Gjykatën e Rrethit të Sofjes nga viti 2005 deri në vitin 2007 dhe që nga viti 2007 është gjykatës në Divizionin Penal në Gjykatën Rajonale të Sofjes. Gjatë karrierës së tij si gjykatës penal ka punuar në mijëra raste dhe thelbi i punës së tij ka qenë që t'iu përmbahet gjithmonë parimeve të KEDNj-së dhe jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Nga viti 2014 deri në vitin 2015 ai u emërua ekspert për zëvendësministrin e Drejtësisë të Republikës së Bullgarisë. Gjatë kësaj periudhe ai ishte përgjegjës për përfaqësimin e vendit para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe duhej të ofronte udhëzime metodologjike dhe kontroll mbi veprimtarinë e Drejtorisë brenda Ministrisë. Përveç detyrave që kanë të bëjnë me përcaktimin e mënyrës së veprimit të përfaqësimit procedural para GjEDNj-së, ai ishte i përfshirë drejtpërdrejt në hartimin e ndryshimeve legjislative në lidhje me gjyqësorin.

Prej vitit 2012 deri në vitin 2015 ka qenë ligjerues musafir rreth të Drejtës Penale në Institutin Kombëtar të Trajnimit për Gjyqësorin, ku ka zgjeruar dhe zhvilluar njohuritë e tij në një nivel më teorik dhe akademik.

Ai iu bashkua EULEX-it Kosovë në vitin 2017 si gjykatës penal ndërkombëtar, ku ka punuar deri në fund të mandatit ekzekutiv të Misionit në vitin 2018. Aktualisht është vëzhgues tematik në fushën e krimeve sipas ligjit ndërkombëtar në EULEX.

Z. Petkov është emëruar anëtar zëvendësues i Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut nga shefja e Misionit të EULEX-it Kosovë më 19 dhjetor 2018.

Z. Alexander Fassihi – Anëtar i EULEX-it, i emëruar më 29 korrik 2021.

Alexander Fassihi mban titullin e masterit në juridik nga Universiteti Uppsala dhe gjithashtu ka studiuar në fakultetin juridik në Universitetin e Torontos. Ai ka punuar gjyqtar i ri në Gjykatën e Qarkut të Vanersborg-ut dhe ushtrues detyre i gjyqtarit të asociuar në Gjykatën e Apelit për Suedinë perëndimore. Përmes punës së tij si gjyqtar në Suedi, ai ka përvojë në zbatimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Z. Fassihi iu bashkua EULEX-it Kosovë në vitin 2020 dhe mban pozitën e monitoruesit mobil (Gjyqësor).

Z. Fassihi u emërua anëtar i Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut nga shefi i Misionit të EULEX-it Kosovë më 29 korrik 2021.

5.2. Sekretariati

Sekretariati i Panelit përbëhet nga një zyrtar ligjor dhe dy përkthyes/Interpret. Sekretariati ndodhet në ambiente të dedikuara ku gjenden administrata, regjistrat dhe arkivat e tij, jashtë vendndodhjes së EULEX-it Kosovë.

Sekretariati ofron mbështetje ligjore dhe administrative, si dhe shërbime gjuhësore për Panelin. Sekretariati pranon gjithashtu ankesa (potenciale) dhe siguron komunikimet dhe korrespondencat midis Panelit dhe ankuesve, dhe përkatësisht shefit të Misionit. Sekretariati mundëson poashtu kontaktet me të gjitha komunitetet e Kosovës.

6. Çështjet operative dhe administrative

6.1. Buxheti

Paneli nuk ka në dispozicion një buxhet të pavarur, edhe pse kërkesat e tij modeste për shpenzime miratohen nga Misioni në baza ad-hoc. Në vitin 2021, kjo përfshinte prodhimin dhe publikimin e dy videove promovuese që prezantonin punën e Panelit (shih më lart nën 4.2.2 Video Informative).

Para përfundimit të mandatit më 14 qershor 2021, Paneli kishte një llogari të dedikuar buxhetore për aktivitetet e fushatës së informimit. Pavarësisht dorëzimit të një kërkese me shkrim në shkurt 2021 për një llogari të re të dedikuar buxhetore, kjo kërkesë nuk u procedua asnjëherë nga Misioni. Si i tillë, pas vazhdimit të mandatit pas datës 15 qershor 2021, Paneli nuk ka llogari buxhetore të ndarë. Megjithatë, Paneli ka marrë garanci verbale se fonde të mjaftueshme për aktivitete të reja informuese mund të vihen në dispozicion aty për aty.

6.2. Burimet njerëzore

Stafi i Sekretariatit të Panelit ka mbetur i njëjtë përgjatë vitit 2021.

7. Konkluzionet dhe rekomandimet

7.1 Konsideratat e përgjithshme

Revokimi gradual i masave të shëndetit publik të vendosura për shkak të pandemisë paraqet një mundësi për Panelin që të përmbushë mandatin e tij me energji të reja. Edhe nëse ngarkesa e tij ekzistuese e lëndëve është reduktuar, me shumicën e rasteve që janë aktualisht në pritje në fazën vijuese, Paneli pret me padurim të angazhohet në kfushatën e informimit dhe të ofrojë mbështetje për Misionin në respektimin e obligimeve të tij ndaj të drejtave të njeriut. Në këtë drejtim, Paneli shpreson se edhe Misioni do t'i qaset zbatimit të rekomandimeve të Panelit me energji të reja tani që pandemia nuk krijon më pengesa.

Siç është theksuar në parathënien e këtij raporti, puna e Panelit do të jetë efektive vetëm nëse Misioni është në gjendje të punojë dhe të përgjigjet menjëherë në një mënyrë në përputhje me detyrimet e tij për të drejtat e njeriut dhe në mënyrë që të sigurohet se është në gjendje të korrigjojë shkeljet e të drejtat e kryera në një kohë më të hershme të ekzistencës së saj.

Paneli gjithashtu shpreson se Misioni do të gjejë mënyra efektive për t'u bërë relevant dhe i dobishëm në përpjekjet e të tjerëve për të hetuar rastet e personave të zhdukur. Paneli, nga ana e tij, do të vazhdojë të ndjekë rastet që janë para tij për këtë temë dhe dotë përpiqet pa pushim të sigurojë një shkallë të përgjegjësisë për ato që kanë qenë dy dekada të trishta, të dhimbshme dhe zhgënjyese për të afërmit e mbijetuar të të zhdukurve.

Paneli gjithashtu synon të vazhdojë punën në trashëgiminë e tij si një mekanizëm unik i llogaridhënies për një operacion paqeje ndërqeveritar pas konfliktit. Në masën që zbatimi i rekomandimeve të Panelit nga Misioni nuk ka qenë plotësisht i kënaqshëm, edhe në vitin 2021, Paneli do të vazhdojë të inkurajojë Misionin që të respektojë rekomandimet e Panelit.

7.2 Pranimi i shkeljeve të të drejtave të njeriut nga EULEX-i

Siç u tha në raportet e mëparshme, Paneli rekomandon edhe një herë që shefi i Misionit, duhet të konsiderojë pranimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut që Paneli ka gjetur se i atribuohen EULEX-it. Një pranim i tillë publik nga Misioni do të ishte një pjesë thelbësore e detyrimeve të tij ndaj të drejtave të njeriut sipas Veprimit të Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP dhe do të shkonte në një farë mënyre drejt korrigjimit të shkeljeve të identifikuara nga Paneli.

Bazuar në sa më sipër, Paneli fton edhe një herë shefin e Misionit, në konsultim me autoritetet përkatëse, të shqyrtojë seriozisht rëndësinë dhe implikimet e pranimit sistematik të përgjegjësive të Misionit në rastet e shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe të shqyrtojë një ndryshim të praktikës në këtë drejtim.

7.3 Programi i reparacionit

Pagesa e kompensimit ose dëmshpërblimi për ankuesit dhe anëtarët e familjes në fjalë është një temë e vazhdueshme në domenin publik në rast të shkeljeve të të drejtave të njeriut nga EULEX-i Kosovë. Fakti që ankesa vërtetohet me konstatimin e shkeljes së të drejtave të njeriut, kjo mund të mos paraqesë mjet efektiv juridik të plotë ose adekuat për shkeljet në fjalë.

Prandaj, rekomandohet që kur konstatohet se Misoni ka kryer shkelje të të drejtave të njeriut, Misioni duhet të konsiderojë seriozisht mundësinë e ofrimit të dëmshpërblimit adekuat, përfshirë kompensimin financiar, kur është e përshtatshme.

Ky sygjerim është bërë tashmë nga Paneli në raportin vjetor të tij të vitit 2018 dhe është përsëritur në raportet vjetore të vitit 2019 dhe 2020. Paneli vëren me keqardhje që sugjerimi i tij mbetet i paplotësuar.

Në të vërtetë, gjetjet dhe rekomandimet e Panelit përbëjnë formën e vetme korrigjuese në rastet që përfshijnë shkelje të të drejtave të njeriut që i atribuohen Misionit së bashku me zbatimin e këtyre rekomandimeve nga shefi i Misionit. Në rastet e shkeljeve të të drejtave të njeriut me ndonjë peshë, siç janë rastet e zhdukjes me forcë (shih në vijim), një lehtësim i tillë mund të thuhet se është plotësisht i papërshtatshëm.

Prandaj, Paneli fton shefin e Misionit të shqyrtojë me kujdes mënyrat e tjera me të cilat Misioni mund të korrigjojë shkeljen e të drejtave të atyre për të cilët Paneli ka thënë se ishin prekur nga veprimi i tij. Është thelbësore që të ndodhë një reflektim i tillë ndërsa Misioni është akoma aktiv në mënyrë që mbyllja e tij të mos mund të shërbejë si *një fakt i kryer* që do t'i sinjalizonte viktimave se shkelja e të drejtave të tyre do të mbetet pa ndonjë mjet efektiv juridik.

7.4 Rastet e personave të zhdukur

Rastet e zhdukjes me forcë përbëjnë shumicën e lëndëve në pritje të Panelit. Secila prej këtyre lëndëve përbën veçori individuale që pasqyrojnë veçantinë e lëndës. Sidoqoftë, këto lëndë pasqyrojnë gjithashtu probleme sistemike që kanë ndikuar në Mision në të kaluarën.

Në veçanti, këto ankesa sugjerojnë që Misioni nuk arriti të përcaktojë përparësitë e rasteve që duhet të kishin marrë vëmendje të konsiderueshme nga Misioni. Pesha e këtyre veprimeve, pasojat e këtyre mbi të drejtat e të zhdukurve dhe të afërmve të tyre të mbijetuar si dhe rëndësia shoqërore e këtyre rasteve në një kontekst pas konfliktit ishin të gjithë faktorë që kërkuan vëmendjen e Misionit dhe hetimin efektiv të këtyre rasteve e bënë gjënë më të rëndësishme.

Fatkeqësisht shumë dhe ndoshta shumica e këtyre rasteve mbetën të pa hetuara ose të hetuara jo si duhet. Të afërmit që mbijetuan në shumë raste nuk kontaktoheshin nga Misioni ose iu ofroheshin informata jo të duhura për sa i përket statusit të lëndës, madje nëse ekzistonte.

Dosjet që kishin të bënin me këto raste mbaheshin në vende të ndryshme, jo gjithmonë të ndara midis organeve të ndryshme të Misionit dhe shpesh ishin mbyllur përpara se të ishte kryer ndonjë hetim i duhur. Bashkërendimi me akterë të tjerë të rëndësishëm ndërkombëtarë duket gjithashtu se ka qenë i pamjaftueshëm në disa raste.

Kjo është veçanërisht për të ardhur keq për rastin e një Misioni të krijuar për të promovuar sundimin e ligjit dhe i përkushtuar në mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Nëse këto lëndë nuk adresohen siç duhet, këto mangësi ka të ngjarë të njollosin reputacionin dhe trashëgiminë e Misionit.

Prandaj, Paneli i bën thirrje shefit të Misionit, vetë Misionit, shteteve anëtare të BE-së dhe vendeve të treta kontribuese, si dhe aktërëve të tjerë përkatës, të punojnë së bashku për gjetjen e një zgjidhjeje për shkeljen e vazhdueshme të të drejtave të njeriut në rastet e zhdukjes së detyruar. Këto raste nuk duhet dhe nuk mund të lejohen të mbeten të pahetuara. Ato janë të rëndësishme, jo vetëm për të afërmit që kanë mbijetuar, por edhe për vetë Kosovën, e cila duhet të përballet me të kaluarën, sado e dhimbshme.

Paneli ishte i kënaqur kur mësoi se shefi i Misionit është i mendimit se kërkohet më shumë progres në çështjen e personave të zhdukur. Ai pohoi se të afërmit kanë të drejtë të dinë se çfarë ka ndodhur dhe se kjo është e drejta e tyre themelore të njeriut. Ai pranoi se autoritetet kudo kanë një detyrim ndërkombëtar dhe ligjor për të bërë gjithçka që munden[2]. Paneli dëshiron t'i kujtojë shefit të Misionit se kjo e përfshin EULEX-in.

Paneli do të mbetet plotësisht i angazhuar që në pjesën e mbetur e mandatit të tij të luaj rolin në përpjekjen për të gjetur një zgjidhje për situatën aktuale dhe të kërkoj të adresoj shkeljet e të drejtave themelore të njeriut që janë të lidhura me këtë situatë që po vazhdon.

7.5 Misioni dhe të drejtat e njeriut

Përveç çështjeve specifike të përmendura në këtë pjesë, Paneli fton Misionin të reflektojë në mënyrat me të cilat mund të sigurohet që pjesa e mbetur e mandatit të tij të kryhet në një mënyrë në përputhje me detyrimet e tij ndaj të drejtat e njeriut. Ai gjithashtu fton Misionin të reflektojë se si mund të ndihmojë në promovimin e një kulture respekti për sundimin e ligjit dhe të të drejtave të njeriut në Kosovë, në mënyrë që trashëgimia e tij të perceptohet nga një këndvështrim pozitiv. Paneli mbetet i përkushtuar të ndihmojë në një proces të tillë.

[2] https://eeas.europa.eu/headquarters/headquarters-homepage/110492/fieldvision-kosovo-healing-scars-war-daily-task_en

SHTOJCA 1 Statistikat 2010 – 2021

	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	Gjithsej
Lëndët e regjistruara - gjithsej	**16**	**28**	**23**	**27**	**42**	**16**	**35**	**7**	**4**	**2**	**1**	**1**	**202**
Lëndët e përfunduara - gjithsej	**6**	**30**	**10**	**20**	**28**	**27**	**19**	**25**	**6**	**4**	**2**	**1**	**178**
E pranueshme	0	7	2	7	2	21	2	2	0	10	5	6	64
E papranueshme	6	22	10	13	21	12	9	23	6	3	2	0	127
Shkelje	0	2	0	7	2	4	9	2	0	4	8	9	51
Nuk ka shkelje	0	5	0	0	1	10	0	0	0	0	0	0	16
Të hequra nga lista	0	1	0	0	3	1	1	2	0	0	0	0	8

	Deri më 31 dhjetor 2021
Lëndët e papërfunduara	24
Të komunikuara te ShM-ja	23

SHTOJCA 2 TABELA E SHKELJEVE ME VENDIMET PASUESE – 31 dhjetor 2021

	Lënda	E pranueshme	Gjetjet	Vendimi pasues	I dytë	I tretë & tutje &	Statusi
1	2010-01	08.04.2011	08.04.2011	23.10.2011			Mbyllur
2	2010-07	08.06.2011	08.06.2011	23.11.2011			Mbyllur
3	2011-07	05.10.2012	10.04.2013	26.11.2013	26.08.2014		Mbyllur
4	2011-20	05.10.2012	22.04.2015	11.11.2015	10.01.2017	27.03.2019; 11.12.2019	Në proces
5	2011-27	13.06.2017	05.12.2017	19.06.2019			Mbyllur
6	2012-09 e tutje	10.04.2013	20.06.2013	05.02.2014			Mbyllur
7	2012-14	07.06.2013	04.02.2014	11.11.2014			Mbyllur
8	2012-19 & 20	*shih 2012-09*	30.09.2013	27.05.2014			Mbyllur
9	2012-22	---	11.11.2015	29.02.2016			Mbyllur
10	2013-03	01.07.2014	12.11.2014	11.11.2015			Mbyllur
11	2013-21	11.01.2017	11.01.2017	13.06.2017			Mbyllur
12	2014-11 e tutje	30.09.2015	19.10.2016	07.03.2017			Mbyllur
13	2014-18	12.11.2015	12.11.2015	11.01.2017			Mbyllur
14	2014-32	11.11.2015	11.11.2015	19.10.2016	07.03.2017		Mbyllur
15	2014-34	29.09.2015	19.10.2016	07.03.2017			Mbyllur
16	2014-37	19.10.2016	19.10.2016	10.01.2017			Mbyllur
17	2016-09	19.06.2019	11.12.2019				Në proces
18	2016-10	19.06.2019	13.02.2020				Në proces
19	2016-11	11.09.2019	11.12.2020				Në proces
20	2016-12	11.09.2019	12.02.2020				Në proces
21	2016-13	11.09.2019	12.02.2020				Në proces
22	2016-14	19.06.2019	11.12.2019				Në proces
23	2016-17	11.12.2019	04.06.2020	11.12.2020			Në proces
24	2016-23	04.06.2020	11.12.2020				Në proces
25	2016-24	11.12.2020	11.12.2020				Në proces
26	2016-28	28.03.2019	11.09.2019	11.12.2020			Në proces
27	2017-02	27.03.2019	19.06.2019	11.12.2019			Në proces
28	2019-01	04.06.2020	11.12.2020				Në proces
29	2016-22	11.12.2020	29.06.2021				Në proces
30	2016-23	004.06.2020	11.12.2020				Në proces
31	2016-24	11.12.2020	11.12.2020				Në proces
32	2016-28	28.03.2019	11..09.2019	11.12.2020			Në proces
33	2016-30	26.03.2021	26.03.2021				Në proces
34	2016-32	29.06.2021	29.06.2021				Në proces
35	2017-02	27.03.2019	19.06.2019	11.12.2019			Në proces
36	2018-01	16.09.2021	16.-09.2021				Në proces
37	2019-01	04.06.2020	11.12.2020	29.04.2021	16.09.2021		Mbyllur

SHTOJCA 3 Vendimet e Panelit 2010-2021

Lënda	Ankuesi	Subjekti	Rezultati
2010-01	Djeljalj Kazagić	Pretendim për mosveprim nga prokurori i EULEX-it, çështje pronësore	Shkelje
2010-02	Sadik Thaqi	Pretendim për mosveprim nga prokurori i EULEX-it, vdekje në burgun e Dubravës, 04/09/2003	Nuk ka shkelje
2010-03	Osman Mehmetaj	Pretendim për mosveprim nga prokurori i EULEX-it, vdekje në burgun e Dubravës, 04/09/2003	Nuk ka shkelje
2010-04	Feti Demolli	Pretendim për mosveprim nga prokurori i EULEX-it, vdekje në burgun e Dubravës, 04/09/2003	Nuk ka shkelje
2010-05	Mursel Hasani	Pretendim për mosveprim nga prokurori i EULEX-it, vdekje në burgun e Dubravës, 04/09/2003	Nuk ka shkelje
2010-06	Latif Fanaj	Pretendim për mosveprim nga prokurori i EULEX-it, vdekje në burgun e Dubravës, 04/09/2003	Nuk ka shkelje
2010-07	Blerim Rudi	Pretendim për moszbatim të urdhrit të lëshuar nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për rikthim në punë të ankuesit nga ana e Njësisë së Inteligjencës Financiare	Shkelje
2010-08	Delimir Krstić	Pretendim për mosveprim nga policia dhe prokuroria e EULEX- it, çështje pronësore	E papranueshme
2010-09	Burim Ramadani	Pretendim për mos-funksionim të sistemit gjyqësor, rasti Kiçina	E papranueshme
2010-10	Horst Proetel	Kandidaturë jo e suksesshme në një pozitë në EULEX	E papranueshme
2010-11	Laura Rudi	Ankesë private financiare ndaj një punëtori të EULEX-it	E papranueshme
2010-12	Hunaida Pasuli	Kandidaturë jo e suksesshme në një pozitë pune në EULEX	E papranueshme
2010-13	Një punonjës i EULEX-it	Kontest i brendshëm në EULEX lidhur me vlerësimin e punës dhe marrëdhëniet personale me mbikëqyrësin	E papranueshme
2010-14	Lulzim Gashi	Kandidim i pasuksesshëm në një pozitë pune në EULEX	E papranueshme
2010-15	Faton Sefa	Mos rikthim në vendin e mëparshëm të punës (sektor privat), pretendim për mos zbatim të vendimit të gjykatës	E papranueshme
2010-16	Cyma Agovic	Transferuar nga EULEX-i – Mos shqyrtim i lëndës së ankueses në mënyrë të drejtë nga ana e gjykatësve të EULEX-it	E papranueshme
2011-01	Familja e Dedë Gecaj-t	Kërkesë për hetim të vendimit të gjykatave të EULEX-it në Kosovë për ekstradim në rastin e të ndjerit Dedë Gecaj	E papranueshme

Lënda	Ankuesi	Subjekti	Rezultati
2011-02	Chamalagai Krishna Bahadur	Pretendim për mosveprim	E papranueshme
2011-03	Afrim Mustafa	Kontest në lidhje me një radio stacion privat dhe konfiskimi i pajisjeve të radio stacionit	E papranueshme
2011-04	Besim Berisha	Ankesë rreth kushteve të jetës në burgun e Dubravës	E hequr nga lista
2011-05	SH.P.K "Syri"	Pretendim për mohim të së drejtës për gjykim të drejtë, liri të shprehjes dhe barazi para ligjit, DhPGjS	E papranueshme
2011-06	Milazim Blakqori	Pretendim për moszbatimin e një vendimi, mosveprim nga ana e EULEX-it	E papranueshme
2011-07	Lënda W	Pretendim për shkeljen e nenit 6 të KEDNj-së	Shkelje
2011-08	Anton Rruka	Pretendim për mohim të së drejtës për gjykim të drejtë, liri të shprehjes dhe barazi para ligjit, DhPGjS	E papranueshme
2011-09	Mirkovic Bojan	Pretendim për largim nga puna në mënyrë të paligjshme nga EULEX-i	E papranueshme
2011-10	Dejan Jovanović	Pretendim për vonesë të panevojshme gjatë procedurave në DhPGjS	E papranueshme
2011-11	Srecko Martinović	Pretendim përdorim të tepruar të forcës, trajtim dhe mohim të së drejtës për gjykim të drejtë	E papranueshme
2011-12	Novica Trajković	Dyshohen në përdorim të tepruar të forcës	E papranueshme
2011-13	S.M.	Pretendim përdorim të tepruar të forcës, mohim të së drejtës për gjykim të drejtë dhe mos respektim të jetës private	E papranueshme
2011-14	Lindita Shabani	Pretendim për mohim të së drejtës për jetë private dhe familjare	E papranueshme
2011-15	Samedin Smajli	Pretendim për mohim të gjykimit të drejtë dhe vonesë të panevojshme gjatë procedurave	E papranueshme
2011-16	Avdyl Smajli	Pretendim për mohim të gjykimit të drejtë dhe vonesë të panevojshme gjatë procedurave	E papranueshme
2011-17	Faik Azemi	Pretendim për mohim të së drejtës për gjykim të drejtë	E papranueshme
2011-18	Mykereme Hoxha	Pretendim për mosveprim nga prokurori i EULEX-it	E papranueshme
2011-19	Sefer Sharku	Pretendim për mos respektim të një vendimi detyrues gjyqësor	E papranueshme
2011-20	X dhe 115 ankuesit e tjerë	Pretendim për mosveprim nga EULEX për mbrojtjen e shëndetit dhe jetës së personave që kanë jetuar në kampet rome të kontaminuara me plumb.	Shkelje
2011-21	Ventor Maznikolli	Pretendim për vonesë të panevojshme nga gjykatësit e EULEX-it rreth caktimit të një seance në Gjykatën Supreme	E papranueshme

Lënda	Ankuesi	Subjekti	Rezultati
2011-22	Hysni Gashi	Pretendim për mohim të një gjykimi të drejtë dhe pretendim për paaftësi të gjykatësve të EULEX-it	E papranueshme
2011-23	Hashim Rexhepi	Pretendim për shkelje të së drejtës për liri dhe të së drejtës për gjykim të drejtë	E papranueshme
2011-24	Predrag Lazić	Pretendim për mos caktimin e një gjykimi të drejtë brenda një afati të arsyeshëm	E papranueshme
2011-25	Shaip Gashi	Pretendim për privim nga pensioni gjerman për persona me paaftësi	E papranueshme
2011-26	Njazi Asllani	Pretendim për mos zbatim të një vendimi, mosveprim nga EULEX-i	E papranueshme
2011-28	Lënda Y	Pretendim për shkelje të së drejtës për respektimin e jetës	E papranueshme
2012-01	Qamil Hamiti	Pretendim për mohim të së drejtës për gjykim të drejtë	E papranueshme
2012-02	Arben Zeka	Pretendim për mos gjykim të një lënde pronësore	E papranueshme
2012-03	Rexhep Dobruna	Pretendim për mohim të së drejtës për gjykim të drejtë	E papranueshme
2012-04	Izet Maxhera	Kontest pronësor me EULEX-in në Mitrovicë	E papranueshme
2012-05	Fatmir Pajaziti	Pretendim për shkelje të së drejtës për liri dhe gjykim të drejtë	E papranueshme
2012-06	Lënda Z	Pretendim për shkelje të nenit 10 dhe 11 të DUDNj-së, nenet 5 dhe 6 të KEDNj-së, nenit 9 të KDDCP-së dhe nenit 6 të KKT-së	E papranueshme
2012-07	Lënda I	Pretendim për mosveprim nga ana e prokurorit të EULEX-it dhe policisë së EULEX-it	E papranueshme
2012-08	Lënda U	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
2012-09	Lënda A	Pretendim për shkelje të neneve 2, 3, 8, 9, 10 dhe 11 të KEDNj-së	Shkelje
2012-10	Lënda B	Pretendim për shkelje të neneve 2, 3, 8, 9, 10 dhe 11 të KEDNj-së	Shkelje
2012-11	Lënda C	Pretendim për shkelje të neneve 2, 3, 8, 9, 10 dhe 11 të KEDNj-së	Shkelje
2012-12	Lënda D	Pretendim për shkelje të neneve 2, 3, 8, 9, 10 dhe 11 të KEDNj-së	Shkelje
2012-13	Bejtush Gashi	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së dhe nenin 1 të protokollit 1 të KEDNj-së	E papranueshme
2012-14	Valbone Zahiti	Pretendim për shkelje të nenit 8 të Konventës	Shkelje
2012-15	Shefqet Emerllahu	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së, mos hetim	E papranueshme
2012-16	Kristian Kahrs	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së, mosveprim	E papranueshme
2012-17	Lënda E	Pretendim për shkelje të neneve 5 dhe 6 të KEDNj-së	E papranueshme

Lënda	Ankuesi	Subjekti	Rezultati
2012-18	Hamdi Sogojeva	Pretendim për shkelje të nenit 1 të protokollit 1 të KEDNj-së	E papranueshme
2012-19	Lënda H	Pretendim për konfiskim të pronës	Shkelje
2012-20	Lënda G	Pretendim për shkelje të neneve 3, 10, 11 të KEDNj-së dhe nenit 1 të protokollit 1 të KEDNj-së	Shkelje
2012-21	Mirko Krlić	Pretendim për shkelje të nenit 9 të KEDNj-së dhe nenit 2 të Protokollit 4 të KEDNj-së	Nuk ka shkelje
2012-22	Zoran Stanisić	Pretendim për shkelje të neneve 3, 6 dhe 8 të Konventës dhe nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës	Shkelje
2012-23	Predrag Blagić	Pretendim për shkelje të nenit 5 të KEDNj-së dhe nenit 2 të protokollit 4 të KEDNj-së	E hequr nga lista
2013-01	Lënda I	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
2013-02	Arsim Krasniqi	Pretendim për shkelje të nenit 3 të KEDNj-së	E papranueshme
2013-03	Goran Becić	Pretendim për shkelje të nenit 5 dhe 14 të KEDNj-së dhe nenit 2 të protokollit 1 të KEDNj-së	Shkelje
2013-04	J	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
2013-05	Lënda K	Pretendim për shkelje të neneve 3, 5, 13 dhe 14 të Konventës	Nuk ka shkelje
2013-06	Lënda L	Pretendim për shkelje të neneve 3, 5, 13 dhe 14 të Konventës	Nuk ka shkelje
2013-07	Lënda M	Pretendim për shkelje të neneve 3, 5, 13 dhe 14 të Konventës	Nuk ka shkelje
2013-08	Lënda N	Pretendim për shkelje të neneve 3, 5, 13 dhe 14 të Konventës	Nuk ka shkelje
2013-09	Lënda O	Pretendim për shkelje të neneve 3, 5, 13 dhe 14 të Konventës	Nuk ka shkelje
2013-10	Lënda P	Pretendim për shkelje të neneve 3, 5, 13 dhe 14 të Konventës	Nuk ka shkelje
2013-11	Lënda Q	Pretendim për shkelje të neneve 3, 5, 13 dhe 14 të Konventës	Nuk ka shkelje
2013-12	Lënda R	Pretendim për shkelje të neneve 3, 5, 13 dhe 14 të Konventës	Nuk ka shkelje
2013-13	Lënda S	Pretendim për shkelje të neneve 3, 5, 13 dhe 14 të Konventës	Nuk ka shkelje
2013-14	Lënda T	Pretendim për shkelje të neneve 3, 5, 13 dhe 14 të Konventës	Nuk ka shkelje
2013-15	Gani Zeka	Pretendim për shkelje të nenit 6 dhe nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNj-së	E papranueshme
2013-16	Almir Susaj	Pretendim për shkelje të nenit 3 dhe 8 të KEDNj-së	E papranueshme
2013-17	Ramadan Rahmani	Pretendim për shkelje të nenit 1 dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme

Lënda	Ankuesi	Subjekti	Rezultati
2013-18	Jovanka, Dragan, Milan Vukovic	Pretendim për shkelje të nenit 1 dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
2013-19	U	Pretendim për shkelje të nenit 1 të protokollit 1 të KEDNj-së	E papranueshme
2013-20	Shaip Gashi	Pretendim për shkelje të nenit 1 të protokollit 1 të KEDNj-së	E papranueshme
2013-22	Gani Gashi	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
2013-23	V	Pretendim për shkelje të nenit 6 dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
2013-24	Emin Maxhuni	Pretendim për shkelje të nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
2013-25	Milorad Rajović	Pretendim për shkelje të nenit 1 të protokollit Nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
2013-26	Selami Taraku	Pretendim për shkelje të nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
2013-27	Shaban Kadriu	Pretendim për shkelje të nenit 6 dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
2014-01	Nexhat Qubreli	Pretendim për shkelje të nenit 6 dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
2014-02	Milica Radunović	Pretendim për shkelje të nenit 3, 8 dhe 13 i KEDNj-së	E papranueshme
2014-03	Lënda A.Z.	Pretendim për shkelje të nenit 1, 3, 6, 14 dhe 17 të KEDNj-së, nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E hequr nga lista
2014-04	Tomë Krasniqi	Pretendim për shkelje të nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
2014-05	Mazlam Ibrahimi	Pretendim për shkelje të nenit 6 dhe nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës	E papranueshme
2014-06	Lënda B.Y.	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
2014-07	Fitore Rastelica	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
2014-08	C.X.	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
2014-09	Rifat Kadribasic	Pretendim për shkelje të nenit 6 dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
2014-11	Lënda D.W.	Pretendim për shkelje të neneve 2 dhe 3 të Konventës	E pranueshme
2014-18	Fitim Maksutaj	Pretendim për shkelje të nenit 6 të Konventës	Shkelje
2014-19	Fahri Rexhepi	Pretendim për shkelje të nenit 6 dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
2014-20	Mensur Fezaj	Pretendim për shkelje të nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
2014-21	Shefki Hyseni	Pretendim për shkelje të nenit 1 të protokollit nr. 1 KEDNj-së	E hequr nga lista
2014-22	Ismajl Krapi	Pretendim për shkelje të nenit 5 të KEDNj-së	E papranueshme

Lënda	Ankuesi	Subjekti	Rezultati
2014-23	Shaip Selmani	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
2014-24	Lënda J.Q.	Pretendim për shkelje të nenit 6 të Konventës	E papranueshme
2014-25	Nuha Beka	Kontest punësimi	E papranueshme
2014-28	Selatin Fazliu	Pretendim për shkelje të nenit 1 të protokollit nr. 1 KEDNj-së	E papranueshme
2014-26	Ajet Kaçiu	Pretendim për shkeljen e nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
2014-27	Qerim Begolli	Pretendim për shkeljen e nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
2014-29	Shemsi Musa	Pretendim për shkeljen e nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
2014-30	Abdilj Sabani	Pretendim për shkeljen e nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
2014-31	Lënda K.P.	Pretendim për shkeljen e nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
2014-32	L.O.	Pretendim për shkeljen e nenit 2 dhe 3 të KEDNj-së	Shkelje
2014-33	Arben Krasniqi	Pretendim për shkeljen e nenit 5 dhe 6 të KEDNj-së	E papranueshme
2014-34	Rejhane Sadiku Syla	Pretendim për shkelje të neneve 2 dhe 3 të Konventës	E pranueshme
2014-36	Lënda Z.A.	Pretendim për shkelje të nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës	E papranueshme
2014-38	Slavica Mikic	Pretendim për shkelje të nenit 13 të Konventës	E papranueshme
2014-39	Musli Hyseni	Pretendim për shkelje të nenit 5 të Konventës	E hequr nga lista
2014-40	Avni Hajdari	Pretendim për shkeljen e nenit 6 të KEDNj-së	E hequr nga lista
2014-41	Liridona Mustafa Sadiku	Pretendim për shkeljen e nenit 2 dhe 3 të KEDNj-së	E papranueshme
2014-42	Bujar Zherka	Pretendim për shkeljen e nenit 6 dhe 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
2015-01	Milos Jokic	Pretendim për shkelje të neneve 5, 6, 8, 9, 10 dhe 12 të Konventës	E papranueshme
2015-03	Dekart Shkololli	Pretendim për shkeljen e nenit 8 të KEDNj-së	E papranueshme
2015-07	Dobrivoje Radovanovic	Pretendim për shkeljen e nenit 6 dhe 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
2015-08	Afrim Berisha	Pretendim për shkeljen e nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
2015-09	Driton Hajdari	Pretendim për shkeljen e nenit 6 dhe 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
2015-10	Shaban Syla	Pretendim për shkeljen e nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
2015-13	Lënda W.D.	Pretendim për shkeljen e nenit 6 dhe 8 të KEDNj-së	E papranueshme

Lënda	Ankuesi	Subjekti	Rezultati
2016-03	Afrim Islami	Pretendim për shkelje të nenit 6 dhe nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës	E papranueshme
2015-04	Nazmi Maloku	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
2014-10	Nikole Sokoli	Pretendim për shkelje të neneve 2, 3 dhe 13 të KEDNj-së	E papranueshme
2016-04	Valon Jashari	Pretendim për shkelje të neneve 3, 6 dhe 8 të KEDNj-së	E papranueshme
2016-02	V.E.	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
2016-01	Skender Jashari	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
2015-15	Đorđe Šmigić	Pretendim për shkelje të neneve 2, 3, 8 dhe nenit 2 të Protokollit nr. 4 të KEDNj-së	E papranueshme
2015-12	U	Pretendim për shkelje të neneve 6, 13 dhe 14 të KEDNj-së	E papranueshme
2015-11	Zvonimir Jovanović	Pretendim për shkelje të nenit 6, dhe nenit 1, Protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
2015-06	X.C.	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
2015-05	Teresa Peters	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
2014-35	M.N.	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
2015-14	Miodrag Konić	Pretendim për shkelje të neneve 2, 3, 8 dhe nenit 2 të Protokollit nr. 4 të KEDNj-së	E hequr nga lista
2015-16	Vuleta Voštić	Pretendim për shkelje të neneve 2, 3, 8 dhe nenit 2 të Protokollit nr. 4 të KEDNj-së	E hequr nga lista
2015-02	Ramadan Hamza	Pretendim për shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
2017-03	Alfred Bobaj	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
2016-36	Namon Statovci	Pretendim për shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 dhe neneve 9 dhe 11 të KEDNj-së0	E papranueshme
2016-33	Agron Bytyçi	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
2016-27	Afrim Islami	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
2016-26	T.G.	Pretendim për shkelje të nenit 8 të KEDNj-së	E papranueshme
2016-25	Hilmi Krasniqi	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
2016-08	Hamdi Hasani	Pretendim për shkelje të nenit 8, dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj- së	E papranueshme
2016-07	Mentor Qela	Pretendim për shkelje të nenit 3, 6 dhe 17 të KEDNj-së	E papranueshme
2016-06/2017-04	Shpresim Uka	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme

Lënda	Ankuesi	Subjekti	Rezultati
2016-05	Axhemi Zyhdi	Pretendim për shkelje të nenit 6, nenit 13 dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
2013-21	Thomas Rusche	Pretendim për shkelje të nenit 6 dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj- së	Shkelje
2011-27	F. dhe të tjerët	Pretendim për mos mbrojtje të dëshmitarit, e drejta për jetë	Shkelje
2016-34	R.I. kundër EULEX	Pretendim për shkelje të nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNj-së	E papranueshme
2016-35	Ndërmarrja Hoteliere Turistike Iliria Deçan kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
2017-01	A.Z. kundër EULEX	Pretendim për shkelje të nenit 3, 6, 9 dhe 14 të KEDNj-së	E papranueshme
2017-05	Hysni Gashi kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
2017-06	Feriz Gashi kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
2017-07	C.X kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
2011-20	X. dhe të tjerë kundër EULEX-it	Pretendohet për dështim nga ana e EULEX-it që të mbroj shëndetin dhe jetën e personave që jetojnë në zonën e kontaminuar me plumb në kampin e romëve	Vendimi i tretë dhe i katërt pasues
2011-27	F. dhe të tjerë kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 2 të KEDNj-së	Vendim pasues
2018-02	D.W. kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 2 të KEDNj-së	E papranueshme
2018-04	Afrim Islami kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së	E papranueshme
2018-03	E.V. kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 1 Protokolli nr. 1 i KEDNj-së	E papranueshme
2017-02	Zufe Miladinović kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 2 dhe 3 të KEDNj-së	E pranueshme, shkelje dhe vendim pasues
2016-28	S.H. kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 2 dhe 3 të KEDNj-së	E pranueshme, shkelje
2016-09	Milorad Trifunović kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 2 dhe 3 të KEDNj-së	E pranueshme, shkelje
2016-14	Milan Ađančić kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 2 dhe 3 të KEDNj-së	E pranueshme, shkelje
2016-10	Dragiša Kostić kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 2 dhe 3 të KEDNj-së	E pranueshme
2016-11	Anđelija Brakus kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 2 dhe 3 të KEDNj-së	E pranueshme
2016-12	U.F. kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 2 dhe 3 të KEDNj-së	E pranueshme

Lënda	Ankuesi	Subjekti	Rezultati
2016-13	Miomir Krivokapić kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 2 dhe 3 të KEDNj-së	E pranueshme
2016-15	Dragan Janačković kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 2 dhe 3 të KEDNj-së	E pranueshme
2016-17	Milijana Avramović kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 2 dhe 3 të KEDNj-së	E pranueshme
2016-10	Dragiša Kostić kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 2 dhe 3 të KEDNj-së	Shkelje
2016-11	Petar Brakus kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 2 dhe 3 të KEDNj-së	Shkelje
2016-12	U.F. kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 2 dhe 3 të KEDNj-së	Shkelje
2016-13	Miomir Krivokapić kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 2 dhe 3 të KEDNj-së	Shkelje
2016-16	Dobrivoje Vukmirović kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 2 dhe 3 të KEDNj-së	E pranueshme
2016-17	Milijana Avramović kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 2 dhe 3 të KEDNj-së	Shkelje dhe vendim pasues
2016-18	P.K. kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 2 dhe 3 të KEDNj-së	E papranueshme
2016-22	Radmila Sapić kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 2 dhe 3 të KEDNj-së	E pranueshme
2016-22	Q.J. kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 2 dhe 3 të KEDNj-së	E pranueshme dhe e papranueshme
2016-23	Vesko Kandić kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 2 dhe 3 të KEDNj-së	E pranueshme dhe shkelje
2016-24	S.H. kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 2 dhe 3 të KEDNj-së	Rishqyrtimi i hedhur poshtë dhe vendim pasues
2016-28	G.T. kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 3	E pranueshme dhe shkelje
2019-01	Reihan Kaja kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 9 dhe 14	E papranueshme
2020-01	E.V. kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 1 Protokolli nr. 1 i KEDNj-së	E papranueshme
Vendimet 2021			
2016-09	Milorad Trifunović kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 2 and 3 të KEDNj-së	Vendim pasues
2016-10	Dragiša Kostić kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 2 and 3 të KEDNj-së	Vendim pasues
2016-13	Miomir Krivokapić against EULEX kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 2 and 3 të KEDNj-së	Vendim pasues

2016-14	Milan Ađančić kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 2 dhe 3 të KEDNj-së	Vendim pasues
2016-15	Dragan Janačković kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 2 dhe 3 të KEDNj-së	Shkelje
2016-16	Dobrivoje Vukmirović kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 2 dhe 3 të KEDNj-së	Shkelje
2016-19	Dušan Milosavljević kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 2 dhe 3 të KEDNj-së	E pranueshme, shkelje
2016-20	Dragica Ćerimi kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 2 dhe 3 të KEDNj-së	E pranueshme, shkelje
2016-21	Milanka Čitlučanin kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 2 dhe 3 të KEDNj-së	E pranueshme, shkelje
2016-22	Radmila Sapić kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 2 dhe 3 të KEDNj-së	Shkelje
2016-30	Svetlana Đorđević kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 2 dhe 3 të KEDNj-së	E pranueshme, shkelje
2016-32	Biljana Đorđevic kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 2 dhe 3 të KEDNj-së	E pranueshme, shkelje
2018-01	Y.B. 2 kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 6 dhe 8 të KEDNj-së	E pranueshme, shkelje
2019-01	G.T. kundër EULEX-it	Pretendim për shkelje të nenit 3 të KEDNj-së	Vendimi i parë dhe i dytë pasues